



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 54/2020 (JR)
Datë 27.11.2020

Vendim nr. 42 (JR)
Datë 08.11.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

| | |
|-----------------------|------------------|
| Ina Rama | Kryesuese |
| Natasha Mulaj | Relatore |
| Albana Shtylla | Anëtare |
| Mimoza Tasi | Anëtare |
| Sokol Çomo | Anëtar |

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 08.11.2022, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit, z. Niko Rapi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 277, datë 21.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Neni F i Aneksit të Kushtetutës. Nenet 58/1/a, 59/1, 62, 63, 64, 65, 66/1, pika “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nenet 47, 51/1, gjerat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Niko Rapi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 të ligjit nr. 84/2016.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe pasi kreu hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, arriti në konkluzionet si më poshtë.

2.1. Për vlerësimin e pasurisë, [...], pamjaftueshmëria financiare e subjektit dhe pasaktësia në deklarin periodik vjetor të vitit 2007, si dhe pamundësia e tij për të provuar realisht mundësitë financiare të babait të tij¹, për të mbuluar me burime të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhënien e huas në vitin 2008, në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për kualifikimin e tyre si mangësi në kuptim të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Në vlerësim të rrethanave, [...], lidhur me konfliktin në dukje të interesit, Komisioni i çmon ato të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, të cilat përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të germës “d”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikat 3 e 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2.2. Për kontrollin e figurës, [...], Komisioni nuk ka pasur të dhëna apo indicie nga cilido burim i ligjshëm në lidhje me kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo veprimtari korruptive të tij.

2.3. Për vlerësimin e aftësive profesionale, [...] subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

3. Në përfundim, Komisioni, bazuar në nenin 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016, nga vlerësimi tërësor i çështjes, duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar, të drejtën e pretenduar dhe qëllimin që synohet të arrihet, të gërshetuara me njëra-tjetrën, konstatoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet e tij, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në këtë logjikë, në faktet dhe në provat e referuara në vendim, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në germën “d”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikat 3 e 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 277, datë 21.07.2020, vendosi, shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, z. Niko Rapi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

4. Kundër vendimit nr. 277, datë 21.07.2020, të Komisionit, në respektim të afateve ligjore, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Niko Rapi, duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e tij në detyrë.

¹ Huadhënësi, babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

5. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat në tërësinë e tyre fokusohen në interpretim të gabuar të ligjit material dhe mos vlerësimin siç duhet të provave të administruara për këtë çështje nga Komisioni.

6. Shkaqet e ankimit, që i përkasin natyrës procedurale dhe parimeve të cenuara të procesit të rregullt ligjor, konsistojnë si vijon.

6.1. Për situatën e konfliktit në dukje të interesit, Komisioni ka kryer një hetim të paplotë, pa marrë një opinion të dytë nga ILDKPKI-ja, sipas praktikës së deritanishme, duke u mjaftuar vetëm me parashikimin në paragrafin 12 të vendimit të ankimit.

6.2. Lidhur me raportin e subjektit të rivlerësimit me avokatin A. Z., Komisioni ka cenuar procesin e rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), pasi me rezultatet e hetimit administrativ nuk i ka dhënë subjektit të drejtën për t’u njohur me konstatimin penalizues, referencën ligjore dhe pasojën e mundshme të saj, duke mos respektuar kështu parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar.

6.3. Komisioni në vendim, një udhëtim në mars të vitit 2011, e shndërron në një *marrëdhënie personale e miqësore me një avokat*, marrëdhënie që sipas Komisionit duhet të ishte e kufizuar, pa marrë në konsideratë prapësimet e subjektit gjatë hetimit administrativ dhe seancës dëgjimore. Ky konstatim nuk i është artikulluar në asnjë fazë të procesit, përveç se në vendimin përfundimtar, premisë kjo e një prove të qartë të shkeljes së elementëve të procesit të rregullt ligjor.

6.4. Komisioni nuk ka argumentuar përfshirjen pa të drejtë në kriterin e aftësive profesionale të denoncimit të shtetasit A. M., që referuar nenit E, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës, duhej të përjashtohet nga analiza e vlerësimit si një çështje në shqyrtim, me efekt rëndues të pozitës së subjektit, duke konkluduar në nivel “minimal kualifikues” të subjektit.

6.5. Komisioni nuk ka dhënë argument bindës se përse nuk është bërë hetim më i plotë i veprimtarisë në tërësi të subjektit të rivlerësimit, si gjyqtar dhe si drejtues i gjykatës, përderisa ai është shkarkuar nga detyra mbi vlerësimin tërësor të procedurave parashikuar nga neni 4 pika 2 dhe neni 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, mbi elementë që lidhen me etikën e integritetit [marrëdhënia personale e shoqërore me një avokat], që në mënyrë të pakuptimtë janë trajtuar te kriteri i vlerësimit të pasurisë.

6.6. Procesi i rivlerësimit në Komision është shoqëruar me shkeljen e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, nenit 12 të Kodit të Procedurave Administrative dhe standardeve të KEDNJ-së, pasi në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, Komisioni nuk ka hetuar dhe vlerësuar tërësinë e veprimtarisë si kryetar gjykatë të subjektit të rivlerësimit, për periudhën prill 2008 – nëntor 2016, duke mos pasur mundësinë të jetë proporcional në marrjen e një masë disiplinore të mundshme.

6.7. Komisioni ka shkelur parimin e sigurisë juridike, pasi në raportin e rezultateve të hetimit administrativ nuk i është atribuar shkelje ligjore në asnjë nga të tria kriteret e rivlerësimit. Me konsideratë jurisprudencën e Komisionit, për rrethana të përafërta apo dhe më të rënda në nivel krahasues, Komisioni nuk ka dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, por ka konfirmuar në detyrë një subjekt që dyshohet se ishte në situatën e konfliktit të interesit ose e ka dërguar për hetim disiplinor pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

7. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit që i përkasin themelit të çështjes, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë për sa vijon.

*7.1. Lidhur me situatën e konfliktit në dukje të interesit me shoqërinë “{***}” ShPK*

7.1.1. Komisioni ka bërë interpretim të gabuar të ligjit material, lidhur me situatën e konfliktit të interesit, si në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar [në vijim “ligji nr. 9367/2005”], ashtu edhe të legjislacionit në fushën e prokurimit publik, menaxhimit buxhetor dhe kontrollit financiar, për sa i përket kompetencave të subjektit të rivlerësimit, si ish-drejtues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

7.1.2. Në kuptim të nenit 4, paragrafi 1, germa “b” dhe nenit 21 të ligjit nr. 9367/2005, duhet që zyrtari të ketë pasur rol dhe funksione reale, thelbësore e përcaktuese në vendimmarrje, ndërkohë që kompetenca e drejtuesit të gjykatës, për të nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik fitues, konkretisht shoqërinë “{***}” ShA, është një veprim krejtësisht formal, duke mos qenë për asnjë moment në ndonjë situatë konflikti interesi me të.

7.1.3. Komisioni nuk ka bërë analizë për hapat metodologjikë që ndiqen në vlerësimin e një situatë të konfliktit të interesit, një analizë e detyrueshme dhe e detajuar e kompetencave të zyrtarit për t’i parë e trajtuar, nëse janë thelbësore e përcaktuese në të kundërt nuk mund të ketë konflikt interesi referuar dhe në “Manual shpjegues dhe trajnimi mbi parandalimin e konfliktit të interesit”, botim i vitit 2006 dhe në “Manual mbi parandalimin e konfliktit të interesave në prokurimet publike”, botim i vitit 2007, të ILDKPKI-së.

7.1.4. Konkluzioni, në paragrafët 6.5, 6.6, 6.8 dhe 6.13 të vendimit të Komisionit, është i pasaktë, i pamjaftueshëm e që natyrshëm të çon në një konkluzion të gabuar. Situata që i atribuohet subjektit të rivlerësimit ajo e “konfliktit të dukje”, e llojit rast për rast apo e llojit të vazhdueshëm, nuk është forma më e rëndë që ndeshet në ligjin nr. 9367/2005. Konkluzioni në paragrafin 6.13 të vendimit, për ta konsideruar motivacion të mjaftueshëm shkarkimin nga detyra, është joproporcional, i paargumentuar dhe jobindës.

7.1.5. Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë disa fakte, si: (i) mosparaqitja e asnjë ankese prej operatorëve ekonomikë konkurrentë në procedurat e prokurimit, as pranë Autoritetit Kontraktor, as pranë Agjencisë së Prokurimit Publik; (ii) vlera shumë e ulët e përfitimit financiar në dobi të shoqërisë fituese, vetëm 173.900 lekë, në periudhën 2013-2016, krahasuar me kapacitetin e shoqërisë “{***}” ShA, si një komponent i rëndësishëm në analizën që i bëhet ekzistencës apo jo në situatën e konfliktit të interesit; (iii) shoqëria “{***}” ShPK në asnjë rast nuk ka qenë palë kontraktore me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

7.1.6. Për një vëzhgues të paanshëm, të arsyeshëm dhe të mirëinformuar, i cili do të ishte në dijeni të procedurave të prokurimit, kushtet e situatës së konfliktit të interesit që i atribuohen subjektit dhe rrethanave konkrete, do të rezultonte se nuk ka shkelje të parimeve në sjelljen e subjektit të rivlerësimit si drejtues i gjykatës. Aspekt që nuk është bërë pjesë e analizës së Komisionit, si në vështrim të legjislacionit vendas, ashtu edhe të Parimeve të Bangalore për Sjelljen Gjyqësore, tërësisht jashtë kontekstit të rastit në fjalë.

*7.2. Lidhur me përdorimin e automjetit, me targë {***}, në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK*

7.2.1. Komisioni nënvlerëson pa asnjë arsytim në vendim dhe pa e vlerësuar me provat e tjera shpresore deklaratën noteriale të datës 07.07.2020, të shtetasit L. B., që në cilësinë e administratorit të shoqërisë konfirmon dorëzimin fizik të këtij mjetei ditën e redaktimit të aktit noterial.

7.2.2. Ndryshe nga sa disponon Komisioni, automjeti është shfrytëzuar vetëm për një udhëtim disa orësh nga Pogradeci në Ohër, Maqedonia e Veriut, në muajin qershor 2016, pavarësisht përmbajtjes së prokurës dhe tagrave të përmendura në të. Përcaktimet në këtë akt kanë qenë standarde, sa i përket tagrave të dhëna apo shtrirjes kohore.

7.2.3. Komisioni ka pasur detyrë ligjore të jetë më i qartë e të përcaktojë se në cilën periudhë subjekti i rivlerësimit ka përdorur këtë automjet përveç datës së aktit noterial 04.06.2016, gjë që nuk e ka bërë, duke evidentuar në mënyrë të pasaktë faktin vetëm nga përmbajtja e aktit noterial. Nga të dhënat e përfuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, del një e dhënë domethënëse që provon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë raport të caktuar me këtë mjet, përveç përdorimit disa orësh të tij, më datë 04.06.2016.

7.2.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se përmbajtja e aktit noterial, në raport me të dhënat e provave të tjera shkresore duke i parë në tërësi e në unitet me njëra-tjetrën, nuk mund të kishte përfundim tjetër përveç vullnetit real të pronarit të automjetit për dhënien në përdorim për të shkuar atë ditë në Ohër, si dhe qëllimi i subjektit nuk ka qenë pajisja me të gjitha tagrat e përmendura në aktin noterial, por mbajtja e mjetit vetëm ditën e aktit noterial për një udhëtim të vetëm, duke e dorëzuar atë me kthimin në vend.

7.3. Lidhur me shpenzimet e udhëtimit në mars të vitit 2011

7.3.1. Komisioni nuk ka argumentuar nëse mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit të subjektit të rivlerësimit, në mars të vitit 2011 në Gjermani, është bërë nga shoqëria “{***}” ShPK, ku në mënyrë kontradiktore me analizën e tij financiare i atribuon subjektit të rivlerësimit faktin se këto shpenzime udhëtimi i janë mbuluar nga shtetasi L. B., çka përbën një fakt të paqenë, të paprovuar dhe që rëndon dukshëm padrejtësisht pozitën e subjektit në vështrim të “trajtimit preferencial” prej një individi/shoqërie.

7.3.2. Komisioni kërkon që subjekti të paraqesë prova e ta bindë për të kundërtën e konstatimit se shpenzimet e këtij udhëtimi ia ka mbuluar një person i tretë, në kushtet e një trajtimi më tepër se miqësor. Në mënyrë të logjikshme e të natyrshme, për shkak të natyrës së këtyre shpenzimeve, subjekti i rivlerësimit është i justifikuar të mos ketë asnjë lloj akti e prove për atë që pretendon Komisioni e për të kundërshtuar, qoftë dhe formalisht gjetjen e tij.

7.3.3. Pavarësisht kohës së gjatë që ka kaluar, subjekti i rivlerësimit ka bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për komunikimin me shoqërinë ajrore “{***}”, për të provuar elementët e pagesës së udhëtimit, duke vlerësuar se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive të parashikuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016

7.4. Lidhur me raportin e subjektit të rivlerësimit me avokatin A. Z.

7.4.1. Komisioni nuk ka ngritur problematikë apo dyshim për ndikim ose njëanshmëri, lidhur me vendimet e subjektit të rivlerësimit në çështjet gjyqësore në të cilat z. A. Z. ka qenë avokat i palës, në periudhën nëntor 2010 - nëntor 2016.

7.4.2. Konkluzioni i Komisionit rezulton i gabuar, pasi nuk janë hetuar një sërë rrethanash, si fakti që raporti mes gjyqtarit dhe avokatit ka qenë i një shkalle njohjeje të zakonshme, aspak në nivel miqësor dhe i krijuar përpara se z. A. Z. të ushtronte profesionin e avokatit dhe përpara udhëtimit në mars 2011, si element i vetëm i sjellë si provë. Komisioni ka anashkaluar dhe nuk ka trajtuar fakte të tilla, si: (i) nuk është kërkuar asnjëherë përjashtimi si gjyqtar nga pala kundërshtare në të gjitha proceset e zhvilluara në periudhën 2011-2016; (ii) nuk ka asnjë ankesë në rrugë administrative, në periudhën 2011-2016, pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, individ apo subjekt tjetër procedural që të ngrinte dyshimin më të vogël për sjellje të njëanshme të subjektit të rivlerësimit kundrejt avokatit; (iii) avokati nuk ka pasur asnjë raport të veçantë apo trajtim të diferencuar pozitiv nga subjekti, i cili në dy raste ka kërkuar nisjen e procedimit disiplinor ndaj këtij avokati.

7.4.3. Në vendimin e Komisionit nuk ka asnjë referim në dispozitat e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji

nr. 96/2016”), asnjë referim në Kodin e Etikës Gjyqësore të Republikës së Shqipërisë apo në ndonjë vendim të GJEDNj-së, përveç citimit të pamjaftueshëm të pikës 4.9 të Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore. Në praktikën e Komisionit dhe Kolegjit nuk provohet se situata të tilla të jenë konsideruar dhe interpretuar se përbëjnë veprime apo mosveprime me efekte të rënda në dëmtimin e imazhit e të besimit të publikut të drejtësia, që kanë çuar në zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

7.4.4. Një fakt i ndodhur 10 vjet më parë, i papërsëritur, në vështrim të parimeve të pavarësisë, paanshmërisë dhe integritetit, nuk ka sjellë efekte të vetë palët në proces në atë kohë dhe as më vonë, pra, nuk ka cenuar paanshmërinë në të dyja testet [objektiv, subjektiv] apo as në dukje të besimit të publikut.

7.4.5. Referuar paragrafit 123 të Komentarit të Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore ka vetëm një raport e një shoqërim të padëmshëm për gjyqtarin e për drejtësinë. Udhëtimi, sipas subjektit, nuk ka qenë pengesë për ta çuar avokatin dy herë në procedim disiplinor, si dhe nuk mund të ngrihet as dyshimi më i vogël për cilësinë, ndershmërinë dhe drejtësinë e subjektit të rivlerësimit në 95 vendimet gjyqësore në të cilat ky avokat ka qenë përfaqësues, në periudhën 2010-2016.

7.4.6. Në jurisprudencën² e Komisionit, në situatën kur subjektet janë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit (marrëdhënie kontraktore, miqësore e shoqërore të hershme, madje në mënyrë të përsëritur), duke mos bërë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, Komisioni ka vlerësuar me të drejtë konfirmim në detyrë apo dërgim për hetim disiplinor, por jo masën e shkarkimit nga detyra, pasi procesi i rivlerësimit bazohet në parime, si proporcionaliteti dhe objektiviteti.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Niko Rapi, vendim të cilin nëpërmjet ankimit subjekti kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara, në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

² Referon në vendimet nr. 26, datë 21.06.2018, nr. 273, datë 10.07.2020, nr. 161, datë 18.06.2019 dhe nr. 276 datë 21.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 277, datë 21.07.2020, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, z. Niko Rapi, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
11. Trupi gjykues i Kolegjit fillimisht shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, me pretendimin se debati gjyqësor është i nevojshëm, në kushtet e një hetimi administrativ të paplotë dhe jo shterues nga Komisioni, për secilin nga motivet e shkarkimit, shkeljeve të rënda procedurale dhe zbatimit të gabuar të ligjit material. Për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova të reja, për të cilat kërkoi marrjen e tyre në cilësinë e provës. Përbushjen e kriterëve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”) dhe përlligjen e mungesës së fajit si element që do të kënaqte këtë nen, subjekti i rivlerësimit e referon te formulimet e paqarta në raportin final, datë 01.07.2020, “Rezultatet e hetimit administrativ”, duke e vendosur atë në pamundësi për të kuptuar nevojën e paraqitjes së provave të tjera.
12. Në përputhje me nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegji, më datë 01.11.2022, para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, si dhe kërkoi administrimin në cilësinë e provës të shkresës nr. {***} prot., datë 24.10.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, lidhur me operatorin ekonomik fitues të procedurave të tenderit për periudhën 2016-2022, që rezulton shoqëria “{***}” ShPK, që zhvillon procedurat e furnizimit nëpërmjet shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe mungesën e ankesave nga operatorë të tjerë, si pranë Autoritetit Kontraktor, ashtu edhe Agjencisë së Prokurimit Publik.
13. Trupi gjykues i Kolegjit, për të konkluduar mbi formën e gjykimit të çështjes, si dhe për të evidentuar shkeljet procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, vlerësoi të trajtojë në fillim shkaqet procedurale të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit.

13.1. Lidhur me pretendimin se për situatën e konfliktit në dukje të interesit Komisioni ka kryer një hetim të paplotë, pa një opinion të dytë nga ILDKPKI-ja, sipas praktikës së deritanishme, duke u mjaftuar vetëm me parashikimin në paragrafin 12 të vendimit, duke pretenduar, gjithashtu, se ky opinion i dytë i nevojitet edhe Kolegjit për të konkluduar se nuk gjendemi në situatën e konfliktit të interesit, trupi gjykues konstaton, si vijon.

13.1.a. Komisioni, në paragrafin 12 të vendimit objekt shqyrtimi, është shprehur se: “Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror. Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse”. Dispozitat ligjore, në vlerësim të trupit gjykues, kanë përcaktuar qartë kompetencat e organeve të rivlerësimit në raport me vlerësimet e kryera nga organet e specializuara të përfshira në këtë proces. Këto dispozita, ashtu siç nuk i detyrojnë organet e rivlerësimit të zbatojnë përfundimet e arritura nga organet ndihmëse, ashtu edhe nuk

i pengojnë t'u drejtohen atyre për një opinion të dytë, të specializuar kur lind nevoja për shkak të rrethanave specifike.

13.1.b. Në këto kushte, praktika e ndjekur në jurisprudencën³ e Komisionit, e sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit në ankim, që i referohet rasteve kur është kërkuar mendim pranë ILDKPKI-së për ndonjë situatë të konfliktit të interesit pas dorëzimit të raportit, sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, nuk do të thotë që ky opinion do të kërkohej në çdo rast, kur diskutohet kjo situatë, pasi organet e rivlerësimit, referuar rrethanave, fakteve dhe provave, në mbështetje të ligjit të zbatueshëm, si dhe ekspertizës ligjore të tyre arrijnë në një vendimmarrje të pakushtëzuar nga opinionet e organeve ndihmëse. Në rastin objekt shqyrtimi, trupi gjykues nuk e gjen të nevojshëm një opinion të ILDKPKI-së dhe vlerësimin e tij mbi këtë situatë e ka arsyetuar në nënparagrafët e paragrafit 19 të këtij vendimi.

13.2. Lidhur me pretendimin se Komisioni, mbi raportin e subjektit të rivlerësimit me avokatin A. Z., ka cenuar procesin e rregullt ligjor, sipas përcaktimeve të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi me rezultatet e hetimit administrativ nuk i ka dhënë subjektit të drejtën për t'u njohur me konstatimin penalizues, referencën ligjore dhe pasojën e mundshme, duke mos respektuar kështu parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar, trupi gjykues, konstaton:

13.2.a. Nga aktet në fashikullin gjyqësor, raporti i subjektit të rivlerësimit me avokatin A. Z. rezulton të jetë sjellë në vëmendje të Komisionit, nga një denoncim anonim (nr. {***} prot., datë 04.03.2020), i cili do të trajtohet më hollësisht në vijim të këtij vendimi, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit *ka udhëtuar jashtë vendit për të parë ndeshje futbolli*, me persona me influencë.

13.2.b. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, si nëpërmjet *e-mail*-it të datës 05.03.2020 dhe pyetësorit të datës 21.03.2020, ka pyetur subjektin e rivlerësimit *“A keni udhëtuar ju me miq, për të parë ndeshje futbolli, në shtete të tjera jashtë Shqipërisë?”*. Në raportin mbi rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni konstaton se *nga sistemi TIMS dhe deklarimet e subjektit rezulton se ai udhëton edhe me shtetasin A. Z., avokat në Studio Ligjore Z., në Pogradec dhe i përfshirë në aktivitete politike në Qytetin e Pogradecit*. Po në këtë raport, Komisioni i bën të ditur subjektit se nga informacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec rezulton se janë dhënë 95 vendime gjyqësore në çështjet ku avokat i njëjës nga palët gjyqësore ka qenë z. A. Z.. Në fund të konstatimeve, Komisioni i kërkon subjektit të japë shpjegime lidhur me to.

13.2.c. Në kushtet kur Komisioni gjatë hetimit administrativ i ka kërkuar subjektit shpjegime në lidhje me udhëtimin e kryer prej tij me avokatin A. Z., duke i bërë me dije dhe informacionin e marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, lidhur me vendimet e dhëna prej tij në 95 çështjet gjyqësore me këtë avokat ose avokatë të tjerë nga Studio Ligjore Z., e bëjnë pretendimin e subjektit, se ai nuk është dëgjuar lidhur me këtë raport, të pabazuar, aq më tepër kur gjatë seancës dëgjimore, subjekti, gjithashtu, ka shpjeguar rrethanat e 2 (dy) udhëtimeve të kryera me të, një për të parë ndeshjen dhe një udhëtim në Strugë, ku subjekti i rivlerësimit ka shkuar për të dhënë leksion në Universitetin {***} të Strugës. Sa i përket vendimmarrjes në 95 çështjet gjyqësore, subjekti i rivlerësimit, si me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, ashtu edhe në seancë dëgjimore, ka sqaruar në mënyrë të detajuar mbi natyrën e këtyre çështjeve dhe vendimmarrjen e tij lidhur me to.

13.2.d. Ndërsa sa i përket pretendimit se Komisioni nuk i ka dhënë të drejtën për t'u njohur me konstatimin penalizues, referencën ligjore dhe pasojën e mundshme nga ky raport, trupi gjykues vlerëson se nëse Komisioni do të kishte përcaktuar që me rezultatet e hetimit

³ *Shih vendimin nr. 161, datë 18.06.2019, me subjekt K. S., faqe 65, pika 2.3, faqe 67, pika 2.9.1, faqe 89, pika 2.3, vendimi nr. 150, datë 28.05.2019, me subjekt R. J., faqe 23, pikat 36.10 dhe 36.10.1.*

administrativ, referencën ligjore apo pasojën, ky fakt do të përbënte paragjykim të çështjes nga ana e Komisionit, që në kuptim të nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i zhvillon bisedimet për marrjen e vendimit pas seancës dëgjimore, pasi ka dëgjuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat që ai mund të depozitojë edhe gjatë seancës.

13.3. Sa i përket pretendimit se Komisioni, një udhëtim në mars të vitit 2011 në vendimin përfundimtar e shndërron në një *“marrëdhënie personale e miqësore me një avokat që duhet të ishte e kufizuar”*, pa marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ dhe seancës dëgjimore, dhe se ky konstatim nuk i është artikuluar në asnjë fazë të procesit, përveç se në vendimin përfundimtar, premisë kjo e një prove të qartë të shkeljes së elementëve të procesit të rregullt ligjor, trupi gjykues e konsideron të pabazuar, pasi:

13.3.a. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit është pyetur nga anëtarët e trupit gjykues lidhur me këtë marrëdhënie, konkretisht, relatorja e çështjes i drejton pyetjen: *“A mendoni ju që trajtimi i çështjeve me këtë shtetas, avokat nga ju cenonte deri diku besimin e publikut te sistemi i drejtësisë [...] pyetja jonë është që shqyrtimi nga ju si gjyqtar i disa proceseve gjyqësore ndër vite me një person të cilin e kishit mik, nuk po them interes, mbase mund të mos kishit marrëdhënie interesi, por kishit marrëdhënie miqësore, a cenonte kjo besimin e qytetarëve të Pogradecit?”*. Po kështu, gjatë seancës dëgjimore kryesuesi i trupit gjykues, ngriti pikëpyetjen se *mbas marrëdhënies dhe mbas udhëtimeve, a duhej që të kishte një përkujdesje më të madhe për të evituar qoftë edhe atë perceptimin e publikut në një konflikt në dukje interesi. [...] mesa duket ju këtë aspekt nuk e keni konsideruar si në pengesë për të vijuar procedimet dhe keni bërë vlerësimin tuaj[...]*”.

13.3.b. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit u përgjigj se nuk kishte raporte miqësore, por njohje aq sa mund të diktojë një komunitet i vogël në një gjykatë të vogël si e ajo e Pogradecit, përsëri pyetjet e trupit gjykues orientoheshin drejt dyshimit për cenim të besimit të publikut, sa më sipër, pretendimi se ky konstatim nuk i është thënë dhe artikuluar në asnjë fazë të procesit, përveç se në vendimin përfundimtar, është i pabazuar.

13.4. Lidhur me pretendimin se Komisioni nuk ka argumentuar përfshirjen pa të drejtë në kriterin e aftësive profesionale të denoncimit të shtetasit A. M., që referuar nenit E, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës, duhej të përjashtohet nga analiza e vlerësimit si një çështje në shqyrtim, me efekt rëndues të pozitës së subjektit, duke konkluduar për nivel “minimal kualifikues” të subjektit, trupi gjykues konstaton se:

13.4.a. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton se denoncimi i shtetasit A. M., i cili lidhet me kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, përfshin 3 pika: *(i) shkelje e etikës profesionale; (ii) zvarritje në proces; dhe (iii) të tjera*. Lidhur me denoncimet në përgjithësi, përfshirë dhe atë të z. A. M., Komisioni, në vendim ka arritur në konkluzionin se në një vlerësim të përgjithshëm të akteve, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, çmon se nuk janë konstatuar gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej tij, e cila mund të çonte në një mungesë të aftësive profesionale të subjektit.

13.4.b. Edhe pse denoncimi i z. A. M. nuk është përfshirë në vlerësimin tërësor që ka çuar në aplikimin e nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlerësimi i këtij denoncimi ka pasur efekt rëndues të pozitës së subjektit, duke konkluduar për nivel minimal kualifikues të tij. Në kushtet kur dosja gjyqësore objekt denoncimi ka qenë një nga tri dokumentet ligjorë të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të procedurave të vlerësimit të aftësisë profesionale të parashikuar nga neni 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe pjesë e raportit nr. {***} prot., datë 16.12.2019, *“Për analizimin e aftësisë profesionale të*

gjqtarit Niko Rapi”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e bën pretendimin e subjektit të pabazuar, pasi ishte vetë ai që e kishte përfshirë në këtë kriter.

13.4.c. Në kuptim të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës, *vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim*, trupi gjykues vlerëson se përderisa është gjykuar kjo çështje gjyqësore dhe për të është marrë një vendim gjyqësor prej subjektit të rivlerësimit, del nga kategoria e atyre çështjeve të përfshira në këtë dispozitë kushtetuese. Trupi gjykues, në kushtet kur ky denoncim nuk ka qenë arsye për masën disiplinore që Komisioni ka marrë ndaj subjektit të rivlerësimit, i udhëhequr nga parimi *no reformatio in peius*, vlerëson se trajtimi i këtij rasti nuk ka peshë në vendimmarrjen e Kolegjit.

13.5. Komisioni nuk ka dhënë argument bindës se përse nuk është bërë hetim më i plotë i veprimtarisë në tërësi të subjektit të rivlerësimit si gjyqtar dhe si drejtues i gjykatës, përderisa ai është shkarkuar nga detyra mbi vlerësimin tërësor të procedurave, sipas neneve 4, pika 2 dhe 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, mbi elementë që lidhen me etikën e integritetin [marrëdhënia personale e shoqërore me një avokat], elementë që në mënyrë të pakuptimë janë trajtuar te kriteri i pasurisë. Procesi i rivlerësimit në Komision është shoqëruar me shkeljen e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, nenit 12 të Kodit të Procedurave Administrative dhe standardeve të KEDNJ-së, pasi në lidhje me situatën e konfliktit të interesit, nuk ka hetuar dhe vlerësuar tërësinë e veprimtarisë si kryetar gjykate të subjektit të rivlerësimit për periudhën prill 2008 - nëntor 2016, duke mos pasur mundësinë të jetë proporcional në marrjen e një mase disiplinore të mundshme.

13.5.a. Trupi gjykues e vlerëson jo të drejtë këtë pretendim të subjektit, pasi e gjen të panevojshëm për vendimmarrjen e tij në vlerësimin tërësor të veprimtarisë së subjektit të rivlerësimit si gjyqtar dhe si kryetar gjykate, *së pari*, kjo metodologji nuk është parashikuar në dispozitat ligjore dhe, *së dyti*, kjo mënyrë do të tejzgjaste procesin e rivlerësimit dhe do të afektonte ekonominë gjyqësore të këtij procesi. Ndërsa pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për përfshirjen në mënyrë të pakuptimë të marrëdhënies me një avokat, në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues e konsideron të drejtë, duke e trajtuar ndryshe nga Komisioni, në këtë vendim.

13.6. Lidhur me pretendimin, se Komisioni ka shkelur parimin e sigurisë juridike, pasi në raportin e rezultateve të hetimit administrativ nuk i është atribuar shkelje ligjore në asnjë nga tri kriteret e rivlerësimit dhe me konsideratë jurisprudencën e Komisionit, për rrethana të përafërta apo dhe më të rënda në nivel krahasues, nuk ka dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, përkundrazi ka konfirmuar në detyrë një subjekt që dyshohej se ishte në situatën e konfliktit të interesit ose e ka dërguar për hetim disiplinor pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, trupi gjykues vlerëson si vijon.

13.6.a. Lidhur me shkakun ankimor se në raportin e rezultateve të hetimit administrativ nuk i është atribuar asnjë shkelje në secilin nga tri kriteret, as referencë ligjore apo pasojë e mundshme, ky pretendim i subjektit nuk është i drejtë, pasi qëllimi i rezultatit të hetimit administrativ është t'i tregojë subjektit se provat e administruara deri në këtë fazë kanë mjaftueshëm nivelin e provueshmërisë për të mbështetur konstatimet e Komisionit, për të cilat subjektit i kalohet barra e provës në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni merr vendim mbi bazën e vlerësimit të situatës faktike që paraqesin provat përgjatë shqyrtimit të çështjes, gjë të cilën e ka konstatuar në këtë mënyrë dhe ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Me fjalë të tjera, mënyra e vlerësimit, si procedurë, është e mbështetur në ligj, pavarësisht se trupi gjykues i Kolegjit në analizë të shkaqeve ankimore dhe provave të çështjes mund të arrijë në një përfundim të ndryshëm nga Komisioni.

13.6.b. Sa i përket transferimit të çështjeve pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, neni 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, gjen zbatim në rastet kur subjekti i rivlerësimit, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, është konfirmuar në detyrë, por që gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision janë evidentuar shkaqe, të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore të një rëndësie të tillë, sa të vetme e në mënyrë të pavarur nuk mund të përbëjnë shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit, referuar nenit 58, pika 1, germa “c” dhe nenit 59, pika 2, lidhur me nenin 61, pika 4 apo nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

13.6.c. Ndërsa sa i përket parimit të sigurisë juridike dhe trajtimit ndryshe nga Komisioni të rrethanave të përafërta apo dhe më të rënda të konfliktit të interesit në rastet e tjera, trupi gjykues vlerëson se vendimmarrja për subjektet që i nënshtrohen rivlerësimit bazohet në provat e administruara, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe në rrethanat konkrete për secilën çështje në shqyrtim.

13.7. Nga analizimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstatohet se procesi i rivlerësimit për subjektin Niko Rapi ka filluar më datë 12.11.2019 dhe ka përfunduar me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 16.07.2020. Gjatë këtij procesi nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ngritur pretendime për pamjaftueshmëri kohore për kthimin e përgjigjeve pyetësorëve apo rezultateve të hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë kërkesë që të jetë refuzuar nga Komisioni. Më datë 02.07.2020 subjekti i rivlerësimit është njohur me aktet e dosjes së hetimit administrativ, dhe ka nënshkruar deklaratën se nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin/materialet e tërhequra. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit është shprehur se *para se të filloj, konfirmoj që nuk kam asnjë pretendim për fazën, për procesin deri në këtë fazë sepse më janë respektuar të gjitha të drejtat, qoftë në fazën e komunikimit elektronik, qoftë në njohjet me materialet [...].* Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka pasur në dispozicion kohën e mjaftueshme për të parashtruar shpjegimet e tij dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga trupi gjykues, si dhe vëzhguesja ndërkombëtare. Për sa më sipër, trupi gjykues nuk konstaton shkelje procedurale që të kërkojnë zhvillimin gjyqësor publik të çështjes.

- 14.** Subjekti i rivlerësimit e ka shoqëruar ankimin e tij me një sërë aktesh shkresore⁴ lidhur me: (i) situatën e konfliktit në dukje të interesit; (ii) përdorimin e mjetit me targë {***}; (iii) udhëtimin

⁴ 1. Lidhur me situatën në dukje të interesit: (i) shkresë nr. {***} prot., datë 10.08.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 17.09.2020, e Shoqërisë “{***}” ShA/ShPK; (iii) ekstrakt historik i regjistrit tregtar të shoqërisë aksionere “{***}”, me {***}, i regjistruar më 11.05.2002, me kapital në vlerën 2.500.000.000 lekë; (iv) ekstrakt historik i regjistrit tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, i regjistruar më 11.05.2002, me kapital në vlerën 544.367.000 lekë; (v) ekstrakt historik i regjistrit tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}, regjistruar më datë 03.03.1997; (vi) “Deklaratë e tatimit të mbajtur në burim” mbi të ardhurat [për ndarje dividenti] më 30.09.2019, e shoqërisë “{***}” ShPK dhe dokumentacioni bankar; (vii) opinion mbi metodologjinë e përlllogaritjes së kamatave, përgatitur nga eksperte audituese ligjore me Nr. {***} licence, A. B. 2. Lidhur me përdorimin e mjetit me targë {***}: (i) shkresë “Kthim përgjigje”, datë 17.08.2020, e noterit E. B.; (ii) shkresë nr. {***} Prot., datë 19.08.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; (iii) vërtetim nr. {***} prot., datë 11.08.2020, i Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, në lidhje me të dhënat e sistemit TIMS, për shtetasin A. B.; (iii) vërtetim i datës 17.09.2020 i lëshuar nga administratori i shoqërisë “{***}” ShPK. 3. Lidhur me udhëtimin për ndeshjen mars 2011: (i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.08.2020, i shtetasve L. B. dhe A. Z.; (ii) vërtetim nr. {***} prot., datë 11.08.2020, i Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, në lidhje me të dhënat e sistemit TIMS, për shtetasin L. B.; (iii) vërtetim noterial me nr. {***} rep., nr. {***} rep., datë 26.08.2020, i komunikimeve elektronike [e-mail] mes Niko Rapi dhe kompanisë ajrore “{***}”. 4. Lidhur me raportin me avokat A. Z.: (i) vërtetim nr. {***} prot., datë 06.08.2020, i Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec; (ii) vërtetim nr. {***} prot., datë 26.08.2020, të Avokaturës së Shtetit; (iii) vërtetim nr. {***} prot., datë 09.09.2020, i Agjencisë së Trajtimit të Pronave, [vërtetime mbi punësimin e mëparshëm të z. A. Z.]; (iv) ekstrakt historik i regjistrit tregtar të personit fizik “A. Z.” i regjistruar më datë 27.10.2010, me NIPT {***}, me veprimtari në fushën e avokatisë, përfaqësime ligjore, ndërmjetësim etj.; (v) vërtetim nr. {***} prot., datë 06.08.2020, i Universiteti {***} i Strugës, Maqedoni, në kuadër të ftesave drejtuar subjektit të rivlerësimit për të qenë i pranishëm në aktivitete me tematika mbi sistemin

për ndeshjen mars të vitit 2011; (iv) raportin me avokat A. Z.; (v) denoncimin e shtetasit A. M.; si dhe (vi) performancën si gjyqtar për periudhën 2001-2020 dhe si kryetar për periudhën 2008-2016, për të cilat kërkon administrimin në cilësinë e provës.

15. Kolegji e shqyrtoi këtë kërkesë nën fokusin e dispozitave ligjore, që normojnë pranimin e provave të reja në gjykimin administrativ të apelit, konkretisht nenit 47⁵ të ligjit nr. 49/2012 në harmoni dhe me parashikimet e nenit 49, pika 6, gjerat “a” dhe “b” e ligjit nr. 84/2016, në të cilat parashikohet se: “*Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) marrja e provës duket se është e panevojshme; (b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjyimit*”. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi konstatoi se provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk plotësonin kriteret e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, për të gëzuar statusin e provave të reja bashkëlidhur ankimit dhe, për më tepër, nga analiza e këtyre akteve në raport me faktet që subjekti synon të provojë, arriti në konkluzionin se ato janë të parëndësishme për zgjidhjen në themel të çështjes, për pasojë vendosi të mos e pranojë këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit.
16. Në përmbyllje të sa më sipër, në analizë të pretendimeve të subjektit, Kolegji e gjeti të pambështetur në fakte e në parashikimet e nenit 51, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 kërkesën për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike e për marrjen e provave të reja. Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vendosi të shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

17. Nga analizimi i vendimit nr. 277, datë 21.07.2020, objekt shqyrtimi, trupit gjykues i rezulton se Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit në procedurat e prokurimit

*gjyqësor në Shqipëri, procesin gjyqësor civil e penal etj.; (vi) shkresë nr. {***} prot., datë 02.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (vii) shkresë nr. {***} prot., datë 02.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (viii) shkresë nr. {***} prot., datë 02.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për periudhën 01.10.2001-18.11.2016, Niko Rapi si gjyqtar i është drejtuar me 5 herë me kërkesë me shkrim Dhomës së Avokatisë Korçë; (ix) shkresë datë 28.08.2020, e Dhomës së Avokatisë Korçë, mbi kërkesat për procedim disiplinor ndaj avokatëve, të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec; (x) shkresë nr. {***} prot., datë 22.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (xi) shkresë nr. {***} prot., datë 28.09.2020, e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, informacion mbi numrin e ankesave të bëra nga gjyqtarët ndaj avokatëve të cilët kanë refuzuar ose nuk kanë marrë pjesë në proceset gjyqësore dhe janë bërë shkak për shtyrje. 5. Lidhur me denoncimin e shtetasit A. M.: (i) vërtetim nr. {***} regj. them., datë 22.09.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 06.10.2020, e Gjykatës së Lartë; (iii) shkresë nr. {***} prot., datë 02.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (iv) shkresë nr. {***} prot., datë 16.10.2020, e Këshillit të Lartë Gjyqësor; (v) shkresë nr. {***} prot., datë 04.09.2020, “Kthim përgjigje shtesë shkresës nr. {***} prot., datë 17.08.2020”, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; 6. Lidhur me performancën si gjyqtar për periudhën 2001-2020: (i) shkresë nr. {***} prot., datë 02.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 02.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (iii) shkresë nr. {***} prot., datë 22.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (iv) shkresë nr. {***} prot., datë 20.08.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (v) shkresë nr. {***} prot., datë 04.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (vi) shkresë nr. {***} prot., datë 17.09.2020, e Këshillit të Lartë Gjyqësor; (vii) shkresë nr. {***} prot., datë 17.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 7. Lidhur me performancën si kryetar gjykatë për periudhën 2008-2016: (i) shkresë nr. {***} prot., datë 02.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (ii) shkresë nr. {***} prot., datë 17.09.2020, e Këshillit të Lartë Gjyqësor; (iii) shkresë nr. {***} prot., datë 17.09.2020, e Ministrisë së Drejtësisë; (iv) shkresë nr. {***} prot., datë 22.09.2020, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (v) shkresë nr. {***} prot., datë 17.09.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec; (vi) shkresën datë 15.09.2020, e Dhomës Vendore të Avokatisë Korçë.*

⁵ Neni 47, i ligjit nr. 49/2012, parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

gjendet në kushtet e *konfliktit në dukje të interesit* me shoqërinë “{***}” ShPK: për shkak të marrëdhënies shoqërore që ai ka me administratorin dhe ortakët e kësaj shoqërie; për faktin se shoqëria “{***}” ShPK është ftuar të marrë pjesë në procedurat e prokurimit në vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015 dhe formulari i sigurimit të kontratës të vitit 2013 është bërë në emër të dy shoqërive, “{***}” ShPK dhe “{***}” ShA, si dhe të gjitha kontratat e tjera ndër vite janë nënshkruar me shoqërinë “{***}” ShA; subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni mbi ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë “{***}” ShPK në fushën e karburanteve, si dhe për bashkëpunimin me shoqërinë “{***}”, ku në mënyrë ekskluzive prej vitesh kryen shpërndarjen e karburantit për këtë shoqëri, fakt i njohur publikisht.

18. Në vendim, Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur trajtime preferenciale/favorizuese nga shoqëria “{***}” ShPK, të cilat duket se shkojnë përtej miqësisë, konkretisht dhënia e huas pa interes në shumën 4.000.000 lekë nga shoqëria tregtare, dhënia e automjetit në zotërim të subjektit apo kryerja e disa udhëtimeve të përbashkëta, duket se janë trajtime preferenciale të kryera, gjithashtu, në kushtet e konfliktit të interesit të padeklaruar, si të tilla, nga subjekti. Subjekti i rivlerësimit kundërshton arsyetimin e Komisionit, i cili sipas tij, bashkon artificialisht këto elementë për ta vendosur atë në situatën e paqenë të *trajtimin preferencial*, për të konkluduar në një situatë *konflikti në dukje interesi*.
19. Lidhur me situatën e konfliktit në dukje të interesit, sa i përket procedurave të prokurimit, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) *Komisioni ka bërë interpretim të gabuar të ligjit material, lidhur me situatën e konfliktit të interesit, si në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9367/2005, ashtu edhe të legjislacionit në fushën e prokurimit publik, menaxhimit buxhetor dhe kontrollit financiar, për sa i përket kompetencave të subjektit të rivlerësimit si ish-drejtues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; (ii) Në kuptim të nenit 4, paragrafi 1, germa “b” dhe nenit 21 të ligjit nr. 9367/2005, duhet që zyrtari të ketë pasur rol dhe funksione reale, thelbësore e përcaktuese në vendimmarrje⁶ndërkohë që kompetenca e drejtuesit të gjykatës për të nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik fitues, konkretisht shoqërinë “{***}” ShA është një veprim krejtësisht formal, duke mos qenë për asnjë moment në ndonjë situatë konflikti interesi me të; (iii) Komisioni nuk ka bërë analizë për hapat metodologjikë që ndiqen për vlerësimin e një shtate të konfliktit të interesit, një analizë e detyrueshme dhe e detajuar e kompetencave të zyrtarit për t’i parë e trajtuar nëse janë thelbësore e përcaktuese në të kundërt nuk mund të ketë konflikt interesi, referuar manualeve shpjegues të ILDKPKI-së të viteve 2006 dhe 2007. Në analizë të këtyre pretendimeve, mbi marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “{***}” ShPK, trupi gjykues i Kolegjit konstaton si vijon.*

19.1. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë hua nga shoqëria “{***}” ShPK, shumën 4.000.000 lekë, të deklaruar si në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë, konkretisht:

19.1.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi pasurinë apartament⁷ banimi me sipërfaqe totale 86 m² dhe garazh me sipërfaqe 17.7 m², në bashkëpronësi me bashkëshorten, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, të përfutur me kontratë shitblerje me kusht dhe rezervë (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2015, me shitës K. Y. dhe blerës Niko Rapi e M. M., në vlerën 10.000.000 lekë [9.000.000 lekë apartamenti dhe 1.000.000 lekë garazhi].

⁶ Referuar te Komentari Ligjor nr. 3 i ILDKPKI-së publikuar në qershor 2006, si dhe udhëzimi nr. 239, datë 02.02.2006, i ILDKPKI-së ku jepen elementët e një kompetence të tillë.

⁷ Konfirmuar, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.03.2020, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri.

19.1.2. Likuidimi i çmimit të kësaj pasurie është deklaruar si vijon: shuma 5.000.000 lekë përfituar me kredinë e marrë pranë “Raiffeisen Bank” ShA, në bazë të kontratë kredie bankare dhe hipotekare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.09.2015⁸; shuma 4.000.000 lekë është marrë hua nga shoqëria “{***}” ShPK, me qendër në Pogradec, regjistruar në QKB me NIPT {***}, me administrator shtetasin L. B., nëpërmjet kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.09.2015 dhe vërtetimit, datë 03.09.2015, të “Raiffeisen Bank” ShA, për kalimin e shumës nga llogaria e shoqërisë, në llogarinë e huamarrësit Niko Rapi me përshkrimin *dhënie huaje për blerje apartamenti*. Shuma, sipas dokumentit “*Njoftim debitimi*”, datë 04.09.2015, ka kaluar në llogarinë e noteres dhe prej saj te shitësi i apartamentit; shuma 1.000.000 lekë është tërhequr nga llogaria e bashkëshortes M. M., duke pakësuar dhe mbyllur llogarinë e kursimit në emër të saj në “Union Bank” ShA, shumë e cila buron nga paga e saj si gjyqtare.

19.2. Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në ankim, subjekti ka sqaruar rrethanat që e çuan në blerjen e apartamentit në Tiranë, si dhe arsyet e marrjes së huas në shumën 4.000.000 lekë, nga shoqëria “{***}” ShPK. Subjekti ka sqaruar se me emërimin e bashkëshortes M. M. gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda në Tiranë, me Dekretin e Presidentit të datës 14 korrik 2015, ishte e detyrueshme zhvendosja me banim në qytetin e Tiranës. Për shkak edhe të fillimit të vitit shkollor për vajzën, nevojitej që familja të sistemohej në një banesë sa më shpejt. Për këtë arsye, vendosën të blinin një apartament dhe jo të merrnin me qira, për shkak të kostos së lartë financiare. Në kushtet kur shuma e kredisë që ofrohej nga bankat nuk mund të ishte më e madhe se 60-70% e vlerës së apartamentit që kishin vendosur të blinin dhe nevoja për një pjesë likuiditeti ishte urgjente, iu drejtua të njohurit të tij, z. L. B., me të cilin kishte marrëdhënie miqësore/shoqërore dhe që i ofroi këtë mundësi.

19.3. Për sa i përket dokumentacionit ligjor që konfirmon këtë marrëdhënie detyrimi dhe gjurmimin e destinacionit të shumës prej 4.000.000 lekësh, nga aktet e dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton si vijon.

19.3.1. Huaja është përfituar nëpërmjet kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.09.2015, e nënshkruar mes huadhënësit, shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori L. B. dhe huamarrësit Niko Rapi. Në këtë kontratë parashikohet që huaja 4.000.000 lekë, kalon nëpërmjet transfertës bankare nga “Raiffeisen Bank” ShA, dega Pogradec, me përshkrimin *dhënie huaje për blerje apartamenti*. Referuar kushteve të kontratës, afati i kthimit të saj do të jetë momenti i shitjes së apartamentit që huamarrësi ka në pronësi, të ndodhur në qytetin e Korçës.

19.3.2. Nëpërmjet dokumentit financiar “*Njoftim debitimi*”, të “Raiffeisen Bank” ShA, datë 03.09.2015, është provuar transferata e shumës 4.000.000 lekë, nga klienti urdhërues “{***}” ShPK te klienti përfitues Niko Dh. Rapi, me detajet e pagesës *dhënie huaje për blerje apartamenti*. Në datën 04.09.2015, kjo shumë është kaluar me urdhërxhirim në llogarinë e noteres Xh. B. me përshkrimin *kalim në bazë të kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.09.2015*.

19.3.3. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se detyrimi 4.000.000 lekë është i pasqyruar edhe në pasqyrën financiare të vitit 2015 të shoqërisë “{***}” ShPK dhe vijon të jetë mbartur edhe në vitin 2017, si një detyrim i pashlyer në favor të huadhënësit. Me këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit paraqet vërtetimin e datës 18.10.2016, të shoqërisë “{***}” ShPK, në të cilën thuhet se në librat kontabël të shoqërisë, z. Niko Rapi ka një detyrim

⁸ Konfirmuar nga “Raiffeisen Bank” ShA, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 04.02.2020, sipas së cilës kredia është përfituar për qëllim blerje shtëpie, sipas kontratës së shitjes me kusht dhe me rezervë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2015.

që në datën 03.09.2015, të pasqyruar edhe në pasqyrat financiare të periudhës dhe të specifikuar analitikisht në shënimet shpjeguese. Në materialin “Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare”, të subjektit “{***}” ShPK, për periudhën 01.01.2015 - 31.12.2015, në zërin “4-Investime të tjera financiare”, citohet se: “Në këtë zë të aktiveve financiare përfshihen kërkesa të arkëtueshme të rezultuara nga dhënia kredi mjete monetare. Në fund të periudhës, ky zë paraqitet në emrin e personit Niko Rapi dhe në shumën 4.000.000 lekë”.

19.3.4. Sa i përket shlyerjes së huas nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se apartamenti i ndodhur në rrugën “{***}”, Korçë, në pronësi të subjektit, shitja e të cilit do të shërbente për shlyerjen e huas, është tjetërsuar nëpërmjet kontratës së shitblerjes (pasuri e paluajtshme) nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.02.2019, te shtetasi A. Z., në vlerën 4.650.000 lekë. Nëpërmjet dokumentacionit financiar “Nxjerrje llogarie” llogaria e klientit Niko Rapi pranë “Raiffeisen Bank” ShA, më datë 15.02.2019, kreditohet në shumën 4.650.000 lekë, me përshkrimin: “[...] Ref. Kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.02.2019, blerje pasurie”. Më datë 18.02.2019, po nëpërmjet kësaj llogarie, kryhet transfera e shumës 4.000.075 lekë në llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, me përshkrimin “Kthim huaje, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.09.2015, Niko Rapi”.

19.4. Nga analiza e deklaratave të interesave privatë periodikë 2015, 2016 dhe 2017, në zbatim të nenit 4, germa “dh” të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, trupi gjykues konstaton se detyrimi financiar ndaj shoqërisë “{***}” ShPK rezulton i deklaruar rregullisht nga të dy bashkëshortët, Niko Rapi dhe M. M..

19.5. Për të identifikuar ndonjë situatë konflikti interesi, Komisioni ka administruar përgjigjet e gjykatave ku kanë ushtruar apo ushtrojnë detyrën e gjyqtarit, bashkëshortët Niko Rapi dhe M. M., për të verifikuar nëse prej tyre është gjykuar ndonjë çështje me personat të cilët kanë pasur marrëdhënie detyrimi me ta. Në këtë kuadër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda⁹, konfirmojnë se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë gjykuar çështje apo dhënë vendime me palë shtetasit H. H.¹⁰, L. B., I. B. dhe A. B., si individ apo në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK. Agjencia e Prokurimit Publik¹¹ informon, gjithashtu, se nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimit Publik shoqëria “{***}” ShPK, me NIPT {***}, është e regjistruar në sistem dhe është shpallur fituese për procedurat e prokurimit elektronik për periudhën 01.01.2009-31.10.2019, duke vënë në dispozicion, listën e institucioneve kontraktore me të, Komuna {***}, Qendra Shëndetësore Pogradec, Ndërmarrja e Rrugëve Rurale Pogradec dhe Agjencia për Zhvillimin Rajonal 3, Korçë. Në këto kushte rezulton që kjo shoqëri nuk ka pasur marrëdhënie kontraktore në fushën e prokurimit me gjykatat ku kanë ushtruar detyrën subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja e tij.

19.6. Me administrimin e një denoncimi nga një grup personash anonim¹² më datë 04.03.2020, adresuar subjektit M. M. dhe bashkëshortit të saj Niko Rapi, Komisioni filloi hetimin administrativ ndaj subjektit Niko Rapi. Duke vlerësuar që *indiciet* e paraqitura në denoncim,

⁹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 19.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; me shkresën nr. {***} prot., datë 19.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë; me shkresën nr. {***} prot., datë 21.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe me shkresën nr. {***} prot., datë 19.11.2019, Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

¹⁰ Me këtë shtetas, subjekti i rivlerësimit ka qenë në një marrëdhënie huaje pa interes në vlerën 500.000 lekë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.09.2011 [shlyer sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.09.2012].

¹¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 06.12.2019 [administruar në dosjen e bashkëshortes M. M.].

¹² Administruar në Komision me nr. {***} prot., datë 04.03.2020.

lidhen me vlerësimin e pasurisë së subjektit dhe situata të mundshme të konfliktit të interesit, e shqyrtoi denoncimin në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë. Nga analizimi i denoncimit, trupi gjykues konstaton se denoncuesit ngrenë pretendimin që shoqëria “{***}” ShPK është në konflikt interesi me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, pasi përveç veprimtarisë së saj në fushën e ndërtimeve, kjo shoqëri ka pika shpërndarje karburanti në bashkëpunim me shoqërinë “{***}” ShA, duke kërkuar hetimin nëse këto kompani kanë përfituar nga procedurat e tenderimit për furnizimin me karburant në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, në kohën kur subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e kryetarit të kësaj gjykate. Në vijim, denoncuesit sjellin në vëmendje faktin se subjekti i rivlerësimit Niko Rapi ka marrë hua për blerjen e apartamentit dhe garazhit në Tiranë nga kjo shoqëri, si dhe ka udhëtuar jashtë vendit për të parë ndeshje sportive me persona me influencë.

19.7. Nga aktet në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se natyrën e marrëdhënies me administratorin dhe ortakët e shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit e ka shpjeguar përpara depozitimit të denoncimit në Komision, që në fillim të hetimit administrativ me përgjigjet e pyetësorit standard, se marrëdhënia me administratorin e kësaj shoqërie shtetasin L. B. dhe me vëllezërit e tij, shtetasit I. dhe A. B., ortakë në të, është një marrëdhënie shoqërore/miqësore e ngushtë. Sipas subjektit, kjo ka qenë arsyeja që në kushtet e kontratës së huas me shoqërinë “{***}” ShPK, afati i shlyerjes së detyrimit nuk ka qenë i përcaktuar, por vetëm që huaja do të kthehej në momentin e shitjes së apartamentit të ndodhur në Korçë. Nisur nga rrethanat familjare, shprehet subjekti, duke marrë në konsideratë që në apartamentin në Korçë kanë vijuar të jetojnë prindërit e tij, shtetasit Dh. dhe L. R., në mirëkuptim me huadhënësin për këtë situatë familjare, apartamenti ka dalë në shitje vetëm pas kalimit të 40 ditëve nga vdekja e nënës së subjektit, më 04.05.2018.

19.8. Në kuadër të këtij hetimi, i pyetur nga Komisioni, mbi lidhjen e tij me shoqërinë “{***}” ShPK, aktivitetin e saj, si dhe dijeninë për bashkëpunimin e kësaj shoqërie me kompaninë “{***}” ShA, me përgjigjet e datës 25.03.2020, subjekti i rivlerësimit fillimisht rikonfirmon marrëdhënien shoqërore/miqësore me administratorin L. B. dhe me vëllezërit e tij, ndërsa sa i përket aktivitetit të shoqërisë, shprehet se aktiviteti shtrihet në fushën e ndërtimit, hotelerisë dhe karburanteve. Më tej, subjekti sqaron se bashkëpunimi i shoqërisë “{***}” ShPK me kompaninë “{***}” ShA, në dijeninë e tij, qëndron në faktin se shoqëria “{***}” ShPK furnizohet me karburant te kompania “{***}” ShA, nën logon e kësaj të fundit, por nuk është në dijeni në mënyrë të hollësishme të llojit dhe karakterit të bashkëpunimit midis tyre në fushën e tregut të karburantit apo në fusha të ndryshme.

19.9. Komisioni, në vijim, i është drejtuar për informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe shoqërisë “{***}” ShA, lidhur me bashkëpunimin me shoqërinë “{***}” ShPK, si dhe pjesëmarrjen në procedurat e tenderimit apo kontratat e nënshkruara me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Në kuadër të këtyre kërkesave, Komisioni administroi dokumentacionin si më poshtë.

19.9.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 30.04.2020, informon se subjekti i rivlerësimit Niko Rapi nuk rezulton të ketë gjykuar si gjyqtar i vetëm apo si anëtar i trupit gjykues gjatë periudhës 02.10.2001-18.11.2016, çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK apo “{***}” ShA. Lidhur me informacionin e kërkuar për procedurat e tenderimit apo kontratat e nënshkruara me shoqërinë “{***}” ShA gjatë kohës që subjekti Niko Rapi ka qenë kryetar i gjykatës¹³, janë përcjellë kopje të njësuara të dosjeve të tenderimit për vitet 2014-2015, kontratat “*Furnizim me karburant*”, për këto vite, si dhe është bërë me dije se kontratat e furnizimit me karburant vijnë të lidhen po me shoqërinë “{***}” ShA. Referuar dokumenteve të prokurimit të vitit 2014 dhe 2015, trupi gjykues

¹³ Në periudhën prill 2008 – nëntor 2016.

konstaton:

19.9.1.1. Për vitin 2014, janë ftuar për të dhënë ofertat e tyre operatorët ekonomikë: (i) “{***}” ShA; (ii) “{***}” ShPK; (iii) “{***}” ShPK; (iv) “{***}” ShPK; dhe (v) “{***}” ShPK, ndërkohë që ka dhënë ofertë vetëm operatori ekonomik, “{***}” ShA.

19.9.1.2. Për vitin 2015, janë ftuar për të dhënë ofertat e tyre operatorët ekonomikë: (i) “{***}” ShA; (ii) “{***}” ShPK; (iii) “{***}” ShPK; (iv) “{***}” ShPK; (v) “{***}” ShPK dhe kanë dhënë oferta operatorët ekonomikë, “{***}” ShA dhe “{***}” ShPK. Oferta e paraqitur nga “{***}” ShA me marzh fitimi 6.5 %, u vlerësua më e mira nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, për shkak të çmimit më të ulët, ndërkohë që marzhi i fitimit për shoqërinë “{***}” ShPK ishte 6.8 %.

19.9.2. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 07.05.2020, përcjell kopje të njësuara të praktikës së procedurave të prokurimit të karburantit edhe për vitin 2012, realizuar nëpërmjet procedurës së blerjeve me vlera të vogla, si dhe për vitin 2013, realizuar nëpërmjet procedurës së tenderimit në faqen e Agjencisë Publike të Prokurimit. Referuar këtyre akteve, trupi gjykues konstaton:

19.9.2.1. Për vitin 2012, sipas procedurës me vlera të vogla, rezulton të ketë qenë pjesëmarrëse edhe shoqëria “{***}” ShPK, por nga tri operatorët ekonomik pjesëmarrës, shoqëria “{***}” ShPK rezultoi fituese, me ofertën me vlerë më të vogël.

19.9.2.2. Për vitin 2013, ishin ftuar për të dhënë ofertat e tyre operatorët ekonomik: (i) “{***}” ShA; (ii) “{***}” ShA; (iii) “{***}” ShPK; (iv) “{***}” ShPK; (v) {***} ShPK. Në këtë prokurim rezultoi që mori pjesë si ofertues, vetëm shoqëria “{***}” ShA.

19.9.3. Nga kontratat për furnizimin me karburant të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec me shoqërinë “{***}” ShA, nuk rezulton të jetë përmendur shoqëria “{***}” ShPK. Në një rast të vetëm në dosjen e prokurimit për vitin 2013, rezulton i administruar “*Formulari i Sigurimit të Kontratës*”, datë 28.03.2013, lëshuar nga Kompania e Sigurimeve {***}, në të cilën citohet se: “*Për Gjykatën Pogradec, ‘{***}’ ShA NIPT: {***} ‘{***}’ ShPK NIPT: {***} [...] vërtetojmë se ‘{***}’ ShA, ‘{***}’ ShPK ka derdhur një depozitë pranë shoqërisë së sigurimeve ‘{***}’ ShA [...], si kusht për garantimin e ekzekutimit të kontratës që do të nënshkruhet me Gjykatën Pogradec [...]*”. Ndërsa në praktikat e prokurimit për vitet 2014 dhe 2015, formulari i sigurimit të kontratës dhe formulari i sigurimit të ofertës, lëshuar nga “{***}” ShA, është vetëm në emër të shoqërisë “{***}” ShA.

19.9.4. “{***}” ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 11.05.2020, sqaron Komisionin se shoqëritë “{***}” ShA (ish “{***}” ShA) dhe “{***}” ShPK marrin pjesë sistematikisht në procedura tenderimi, me qëllim ofrimin e naftës dhe produkteve të tjera hidrokarbure, subjekteve të ndryshëm publikë, një ndër të cilët ka qenë edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Shoqëria informon se nuk disponon pikë karburanti në qytetin e Pogradecit, me qëllim ofrimin e këtij produkti në qytetet ku nuk disponon distributor, me një marrëveshje *tip* për pranim tollonash (sikundër me shoqëri të ndryshme në rrethet ku “{***}” ShA dhe “{***}” ShPK, kanë marrë pjesë në procedura tenderimi), shoqëria ka rregulluar këtë marrëdhënie me shoqërinë “{***}” ShPK, të cilës i ka kaluar të drejtën e përdorimit të logos së kompanisë, me qëllim furnizimin e subjekteve nga të cilat kjo kompani është kontraktuar. Shoqëria “{***}” ShPK prej shumë vitesh, që para vitit 2010, ka në mënyrë ekskluzive në Pogradec të drejtën e mbledhjes së tollonave me të gjithë subjektet shtetërore, praktikë që ndiqet dhe aktualisht me të njëjtën marrëveshje *tip*, të cilën nuk e disponon për shkak të periudhës së gjatë që ka kaluar. Në procesin e prokurimit, shoqëria shprehet se ka marrë pjesë si subjekt më vite dhe në asnjë rast si bashkëkonkurreuese apo në bashkëpunim me shoqërinë “{***}” ShPK. Shoqëria “{***}” ShA sqaron, gjithashtu, se prej shumë vitesh, furnizon nëpërmjet shoqërisë “{***}” ShPK, disa

institucione në rrethin e Pogradecit në kuadër të detyrimit kontraktor me to dhe nuk ka pasur një marrëveshje të posaçme për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, furnizimi me karburant i të cilës ka nisur në vitin 2013 e vijon aktualisht.

19.9.5. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni i kërkon gjykatës nëse disponon marrëveshjen *tip* të shoqërisë “{***}” ShA me shoqërinë “{***}” ShPK, për shpërndarjen e karburantit dhe dijeninë mbi faktin që procedura ndiqet nga shoqëria “{***}” ShPK. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.06.2020, informon se nga verifikimi i dosjeve të tenderave zhvilluar në vite, ku si fitues ka qenë shoqëria “{***}” ShA, gjatë fazës së zbatimit të kontratës nuk është administruar ndonjë kontratë apo marrëveshje e lidhur mes shoqërisë “{***}” dhe shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe nuk kanë dijeni që të ketë marrëveshje ndërmjet shoqërisë “{***}” e shoqërisë “{***}” ShPK, si pjesë e praktikës së tenderimit, nuk ka ndonjë marrëveshje *tip* lidhur mes këtyre dy shoqërive, por janë në dijeni që procedura e furnizimit do të bëhej pranë shoqërisë “{***}” ShPK, sipas kushteve të kontratës, pasi kjo e fundit furnizohet me karburant nga shoqëria “{***}”. Furnizimi me karburant bëhet nga shoqëria “{***}” ShPK që nga viti 2012 e deri aktualisht.

19.10. Komisioni i kalon barrën e provës subjektivit të rivlerësimit lidhur me konstatimin se përse një shoqëri tregtare krijuar për të nxjerrë fitime nga biznesi do të ishte e interesuar për t'i dhënë hua 4.000.000 lekë, pa interes një personi privat që nuk ka asnjë lidhje me këtë shoqëri. Për këtë konstatim, subjekti shpjegon se pavarësisht faktit që huadhënës në këtë marrëdhënie është një shoqëri tregtare me aktivitet në fushën e ndërtimit, karburanteve, hotelerisë etj., dhe jo të huadhënies e që ka për qëllim nxjerrjen e fitimeve, përpilimi i një kontrate huadhënie pa interes ka qenë dëshira e administratorit të shoqërisë L. B. dhe dy vëllezërve të tij bashkëortakë, të cilët kanë vlerësuar në atë moment dhënien hua të kësaj shume nga likuiditetet e shoqërisë dhe jo nga likuiditete personale, pasi në këtë periudhë shoqëria nuk kishte shpërndarë dividend.

19.11. Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit sjell, gjithashtu, në vëmendje disa faktorë lidhur me procedurën e prokurimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, që duhen mbajtur në konsideratë gjatë vlerësimit të çështjes, konkretisht: (i) organika e vogël e institucionit ka bërë që njësit e prokurimit ndër vite kanë qenë të pandryshueshme ose të ndryshme pjesërisht; (ii) drejtuesi i gjykatës nuk mund të lidhë kontratë me një operator ekonomik ndryshe nga ai që i rekomandon Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, por mund të vendosë kthimin e procedurës për elementë proceduralë, gjë që nuk ka ndodhur, duke mos u bërë faktor në këtë proces e aq më pak në favor të subjektivit “{***}” ShA/ShPK, operator me veprimtari të gjerë e të konsoliduar prej vitesh në tregun e karburanteve; (iii) nuk është depozituar asnjë ankim pranë Agjencisë së Prokurimit Publik apo anulim i procedurës, që nga viti 2015 (kur është lidhur kontrata e huas midis subjektivit dhe shoqërisë “{***}” ShPK), asnjë rast që ILDKPKI-ja të konstatonte situatën e konfliktit të interesit për subjektivin e rivlerësimit, si dhe asnjë rast që në procedurat e tenderimit të gjendej ndonjë shkelje nga sektori i auditimit pranë ZABGj-së¹⁴; (iv) në një rast të vitit 2012, siç del nga procesverbali i mbajtur më datë 01.11.2012, mbi bazën e urdhërit për prokurim me vlera të vogla, është kualifikuar fituese shoqëria “{***}” ShPK mbi kriterin e çmimit më të ulët, ndërsa shoqëria “{***}” ShPK është kualifikuar e dyta, pra, edhe në një situatë të tillë subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt.

19.12. Në vijim të situatës faktike të parashtruar më sipër, trupi gjykues, për të analizuar faktin nëse subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit me shoqërinë “{***}” ShPK, referon dispozitat e ligjit nr. 9637/2005, të cilat përkufizojnë këtë situatë, konkretisht, në nenin 3, pika 1, parashikohet se: “Konflikt interesi është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë

¹⁴ Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike". Në drejtim të ushtrimit të funksionit si gjyqtar, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, pasi nuk ka gjykuar apo dhënë vendime për çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK, administratorin apo ortakët të saj, si dhe shoqërinë “{***}” ShA.

19.13. Lidhur me ushtrimin e funksionit si drejtues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në të njëjtën kohë titullar i autoritetit kontraktor në procedurat e prokurimit me shoqërinë “{***}” ShA, trupi gjykues, mbështetur në situatën faktike më sipër dhe legjislacionin e zbatueshëm, vlerëson se subjekti i rivlerësimit do të ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit për shkak të marrëdhënies së shoqërisë/miqësisë me administratorin dhe ortakët e shoqërisë “{***}” ShPK, që në kuptim të nenit 5, pika 1, germa “dh”, nëngerma “v” e ligjit nr. 9637/2005, do të përbënte një interes privat, vetëm nëse kontrata e furnizimit me karburant do të nënshkruhej nga subjekti i rivlerësimit me shoqërinë “{***}” ShPK, e vetme ose si bashkim shoqëriash/operatorësh, në kuptim të nenit 44, pika 2 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Pra, vetëm në një situatë të tillë, mund të ngrihej për diskutim çështja e konfliktit faktik të interesit në cilësinë e drejtuesit të gjykatës.

19.14. Ndërsa sa i përket konfliktit në dukje të interesit me shoqërinë “{***}” ShPK, Komisioni në vendim e lidh këtë situatë me faktin e dijenisë që ka pasur subjekti i rivlerësimit për aktivitetin e kësaj shoqërie në fushën e karburanteve dhe bashkëpunimin e saj me shoqëritë “{***}”, që prej vitit 2013, si fakt i njohur botërisht, duke referuar legjislacionin e aplikueshëm, konkretisht ligjin nr. 9367/2005 dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 3, pikat 13/a dhe 20, neni 26, pika 1, germa “b” dhe pika 2, germa “c” e shtojcës nr. 6. Trupi gjykues konstaton se këto dispozita përcaktojnë kuptimin e termave “*ofertues*” dhe “*kërkesë për propozim*”, si dhe rastin kur autoriteti kontraktor refuzon ofertën apo një kërkesë për pjesëmarrje në tender, nëse ofertuesi ose kandidati është në kushtet e konfliktit të interesit. Nga analizimi i nenit 26 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i kreut V, pika 1 të vendimit nr. 1, datë 10.01.2007, të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe neneve 16, 56 dhe 64 të vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet detyrimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, si dhe detyrimi i anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për të nënshkruar deklaratën që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Në kuptim të këtyre dispozitave, titullari i autoritetit kontraktor nuk lejohet të drejtojë një komision apo të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes. Në momentin e hapjes së ofertave janë vetëm zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave, që nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës.

19.15. Referuar “*Manual nr. 2, mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Prokurimet Publike, Maj 2009*”, shmangia nga parimet e përgjithshme bazë, [mosdiskriminimi, transparenca dhe barazia në trajtimin e kërkesave, si dhe detyrimet që u ngarkohen operatorëve ekonomikë], ecën paralel me shfaqjen e konfliktit të interesave. Sipas këtij manuali në prokurimin publik deklarimi dhe kontrolli i ekzistencës së konfliktit duhet të bëhet rast pas rasti. Zyrtari publik duhet të analizojë e vlerësojë një sërë faktorësh¹⁵. Titullari i autoritetit

¹⁵ Faktorë sipas një radhe, e këshillueshme të jetë si vijon: 1. cilat janë detyrat dhe kompetencat konkrete të zyrtarit në procesin e përzgjedhjes apo vendimmarrjes, në rastin konkret të prokurimit publik?; 2. a ka ai zyrtar kompetencë thelbësore dhe/ose përcaktuese?; 3. cilat janë interesat private të zyrtarit në fjalë që ndërhyjnë në procesin e prokurimit?; 4. a ka mundësi që këto interesa private të jenë në diskutim edhe në të ardhmen për procedura prokurimi që institucioni publik, për të cilin zyrtari punon, planifikon ose mund të planifikojë?; 5. çfarë mundësish ka që përzgjedhja e palës kontraktuese të ndikohet nga interesat private të zyrtarit, në dobi të këtij të fundit?; 6. çfarë mundësish ka që ato interesa të ndikojnë pozitën e atij zyrtari në procesin e përzgjedhjes së palës kontraktuese?; 7. çfarë mundësish ka që interesat private të zyrtarit të krijojnë mundësi për një konflikt të mundshëm interes; 8. çfarë mundësish ka që interesat private të zyrtarit të prodhojnë një situatë konflikti interesi

kontraktor referuar këtij manuali, në këtë procedurë është i përfshirë në fazën e nxjerrjes së urdhrat të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik fitues, ndërkohë që përgatitja e dokumenteve standard të tenderit dhe njoftimi i kontratës i përket anëtarëve të njësisë së prokurimit, ndërsa hapja dhe vlerësimi i ofertave, Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

19.16. Pavarësisht se titullari i autoritet kontraktor është përgjegjës për ngritjen e njësisë së prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave dhe detyrat e tyre, duke pasur parasysh kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, në emërimin e një nëpunësi prokurimi në procesin e prokurimit, kompetencat e tij nuk mund të konsiderohen përcaktuese dhe thelbësore në procedurën e përzgjedhjes së operatorit ekonomik fitues, që do të çonin titullarin e autoritetit kontraktor në kushtet e konfliktit të interesit, ndërkohë që detyrat e tij kryhen në respektim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në cilësinë e nëpunësit autorizues, si titullar i njësisë shpenzuese.

19.17. Në vlerësimin mbi situatën e konfliktit në dukje të interesit, lidhur me procedurën e prokurimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, trupi gjykues mban në konsideratë disa rrethana konkrete: (i) në këtë procedurë ndër vite, shoqëria “{***}” ShA ka kandiduar vetëm dhe është shpallur fituese, duke ofruar sipas rastit, ofertën e vetme ose atë me vlerë më të ulët; (ii) subjekti i rivlerësimit si titullar i autoritetit kontraktor nuk ka nënshkruar kontratë për furnizimin me karburant me shoqërinë “{***}” ShPK; (iii) operatori ekonomik shoqëria “{***}” ShA nuk ka pasur një fitim të konsiderueshëm nga procedura e prokurimit me gjykatën, në raport me fitimin e realizuar në vit nga aktiviteti në këtë fushë; (iv) subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues dhe ka nënshkruar kontratën me operatorin e përzgjedhur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave; (v) gjatë kohës që subjekti ka pasur rolin e titullarit të autoritetit kontraktor nuk ka pasur asnjë ankesë nga operatorët e tjerë pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, mbi procedurën e prokurimit apo operatorin ekonomik fitues.

19.18. Nga analizimi i situatës faktike më sipër, provohet që subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit as në cilësinë e drejtuesit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, si titullar i autoritetit kontraktor, pasi në kuptim të nenit 3, pika 4, germa “a” e ligjit nr. 9367/2005, ai nuk ka nënshkruar kontratën e furnizimit me karburant me shoqërinë “{***}” ShPK. Konflikti në dukje i interesit, i përcaktuar në nenin 3, pika 4, germa “b” e këtij ligji si, *gjendja, në të cilët interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por në fakt ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë*, në kushtet kur është i njohur botërisht fakti që shoqëria “{***}” ShPK operon nën logon e shoqërisë “{***}” ShA, parë në raport me marrëdhënien e miqësisë së subjektit të rivlerësimit me administratorin dhe ortakët e shoqërisë “{***}” ShPK, duket sikur komprometon perceptimin e publikut, mbi një konflikt në dukje interesi të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të gjykatës, perceptim i cili nga ana tjetër nuk mund të shmangej edhe nëse kontrata e furnizimit me karburant do të nënshkruhej në këtë rast nga një person tjetër i deleguar prej tij. Konflikti në dukje i interesit, për vetë elementët karakterizues të tij, të tillë si *ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë* nuk mund të ngrihet në situatën e kërkuar nga neni 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016 e që, për pasojë, do të çonte subjektin e rivlerësimit, në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm të përcaktuar në nenin 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, dhënia e huas nga shoqëria “{***}” ShPK,

në dukje?; 9. a ka lidhje të fortë shkak-pasojë mes interesave dhe akteve të miratuara përmes proceseve të prokurimit apo të kontratave të lidhura në përfundim të këtij procesi?.

nuk mund të konsiderohet e dhënë në kushtet e një trajtimi preferencial ndaj subjektit të rivlerësimit për shkak të procedurës së prokurimit, por për shkak të marrëdhënies së miqësisë së ngushtë të administratorit dhe ortakëve të shoqërisë me subjektin e rivlerësimit, marrëdhënie e cila është konfirmuar nga vetë subjekti përpara se Komisioni të hetonte për këtë situatë dhe nuk duhet të kualifikohet si interes privat, kur nuk lidhet me ushtrimin e funksionit të drejtuesit të gjykatës.

19.19. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se konflikti në dukje i interesit, i parashikuar në nenin 3, pika 4, germa “b” e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, nuk përfshihet në parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet konfliktit faktik të interesit të parashikuar në nenin 3, pika 4, germa “a” e ligjit nr. 9367/2005, që do të çonte, për rrjedhojë, në zbatimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë.

- 20.** Lidhur me mungesën e burimeve financiare në vitin 2007 dhe dhënien e huas në vitin 2008, Komisioni në vendim ka arritur në konkluzionin se [...] *pamjaftueshmëria financiare e subjektit dhe pasaktësia në deklarimin periodik vjetor të vitit 2007, si dhe pamundësia e tij për të provuar realisht mundësitë financiare të babait të bashkëshortes, për të mbuluar me burime të ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhënien e huas në vitin 2008, në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, nuk përbëjnë shkak të mjaftueshëm për kualifikimin e tyre si mangësi, në kuptim të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.* Pavarësisht se Komisioni nuk e ka ngritur pamjaftueshmërinë në vitin 2007, si dhe mundësinë financiare të huadhënësit Sh. M. në nivel për të ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, përsëri ky i fundit nëpërmjet ankimit ka ngritur disa pretendime.
- 21.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se pasaktësia në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, për pakësimin e gjendjes *cash* të vitit 2006 dhe deklarimi i përdorimit të shumës 500.000 lekë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, si dhe aftësia financiare e huadhënësit Sh. M. në dhënien e huas në masën 800.000 lekë, më datë 14.02.2008, janë dy elementë të trajtuar ndryshe në vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit M. M.. Komisioni në këtë mënyrë ka shkelur parimin e sigurisë juridike, duke qenë se ligjshmëria e këtij kriteri është zgjidhur tashmë me vendim të formës së prerë prej tij, në kuptim të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile dhe nuk mund të cenohet me një vendim të mëvonshëm, qëndrim i konsoliduar tashmë në praktikën¹⁶ e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
- 22.** Trupi gjykues, në analizë të këtij shkakut ankimor, konstaton se lidhur me shumën 500.000 lekë, në vendimin¹⁷ që i përket subjektit të rivlerësimit M. M., Komisioni ka arritur në konkluzionin se *subjekti ka kryer deklarim të mjaftueshëm në lidhje me njërin prej burimeve të kësaj pasurie, konkretisht përdorimin e shumës 500.000 lekë, të krijuar nga kursimet, ndërsa në paragrafin 3.8.9 të vendimit objekt shqyrtimi ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja janë në pamjaftueshmëri për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pagesën në shumën 500.000 lekë të këstit të apartamentit, duke rezultuar me një diferencë negative në shumën 405.550 lekë, në vitin 2007.* Lidhur me huan në shumën 800.000 lekë të marrë nga babai i bashkëshortes, z. Sh. M., në vitin 2008, në vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit M. M., Komisioni krijon bindjen se *huadhënësi ka pasur mundësi financiare për të dhënë hua shumën 800.000 lekë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shumë e deklaruar se është*

¹⁶ Vendimi nr. 23, datë 08.06.2007, vendimi nr. 49, datë 22.07.2016, vendim nr. 7, datë 10.02.2014, vendim nr. 12, datë 17.03.2014, etj. Shih çështjen *Kehaya and others v. Bulgaria*.

¹⁷ Shih: <https://kpk.al/znj-miliana-muca-gjyqtare-ne-gjykatën-e-posacme-te-shkalles-se-pare-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/36/>. Vendimi nr. 234, datë 04.02.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, paragrafët 3.23.4 dhe 3.39, fjalia e fundit.

përdorur si një ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie. Ndërsa në paragrafin 3.10.8 të vendimit objekt ankimi, Komisioni është shprehur se duke marrë në konsideratë dhe jurisprudencën e Kolegjit, Komisioni konstaton se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk mund të konsiderohet si dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, duke mos provuar mundësinë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhënien e huas në vitin 2008. Në kushtet kur Komisioni për të njëjtat fakte e prova ka arritur në konkluzione të ndryshme, trupi gjykues gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit për trajtim ndryshe, por nga ana tjetër e gjen pa peshë në vendimmarrjen e tij. Megjithatë, në kushtet kur çështja është regjistruar për shqyrtim në Kolegj, do të trajtohet sipas qëndrimit të Kolegjit në jurisprudencën e tij.

23. Lidhur me shlyerjen e këstit prej 500.000 lekësh, më datë 19.02.2007, me kursimet e vitit 2006, subjekti pretendon se: (i) ky fakt nuk është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë vetting, por në deklaratën periodike të vitit 2008, që duhet të përdoret si provë në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016; (ii) balanca negative e vlerësuar nga Komisioni në vitin 2007 vjen si pasojë e mosnjohjes së pasaktësisë në deklaratën e vitit 2007, mospasqyrimi i pakësimit të gjendjes cash të vitit 2006, e lidhur dhe me faktin se në analizën financiare të vitit 2007, Komisioni pasqyron kursime të vitit 900.000 lekë, teksa mbetet kontradiktor vendimi, pasi në paragrafin 3.8.3 të vendimit shprehet se kursimet cash janë 200.000 lekë, ndërsa në pikën 3.8.6 shprehet se kursimet në këtë vit rezultojnë në vlerën 900.000 lekë; (iii) kursimet e vitit 2007 nuk kanë qenë 900.000 lekë, referuar deklaratave vjetore 2007 të secilit prej bashkëshortëve, bërë me dije Komisionit në qëndrimin me shkrim mbi rezultat e hetimit administrativ se gjendja cash ka qenë 200.000 lekë, si diferencë e kursimit cash të vitit 2006, fakt që nuk u reflektua në vendimin e arsyetuar të Komisionit; (iv) duke sjellë në vëmendje jurisprudencën¹⁸ e Kolegjit, pakësim të gjendjes cash të vitit 2006, në deklaratën vjetore 2007 të ishte trajtuar si një pasaktësi që merr një vlerë minimale. Trupi gjykues, në vlerësim të këtyre pretendimeve, konstaton si vijon.

23.1. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimi deklaroi blerje apartament banimi¹⁹ në qytetin e Korçës, rruga “{***}” (sot rruga “{***}”), me sipërfaqe 98 m², në vlerën 3.800.000 lekë. Në aktmarrëveshjen e datës 15.02.2007, të nënshkruar ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK dhe blerësit Niko Rapi, parashikohet që pagesa do të bëhet në këste, pagesa e parë 1.000.000 lekë dhe pjesa tjetër 2.800.000 lekë, pa përcaktuar datat e pagesave. Më datë 03.09.2008 nënshkruhet kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol. Lidhur me burimin e krijimit të pagesës në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit deklaroi se shuma prej 1.000.000 lekësh e parapaguar në favor të firmës ndërtuese “{***}” ShPK, sipas aktmarrëveshjes së datës 15.02.2007 është kryer: sipas dokumentit “veprim arke, tërheqje cash”, datë 13.02.2007, tërhequr nga llogaria pranë “Raiffeisen Bank” ShA, shuma 500.000 lekë, kursime nga paga; pjesa tjetër prej 500.000 lekësh ka qenë gjendje cash në banesë, kursime nga paga dhe të ardhura familjare të deklaruara edhe në deklaratën periodike të vitit 2006. Për shlyerjen e shumës 2.000.000 lekë, si pjesë e çmimit 3.800.000 lekë për blerjen e apartamentit, subjekti deklaroi marrjen e kredisë bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare, sipas kontratës së kredisë nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 06.03.2007.

¹⁸ Shih vendimin nr. 20/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit [paragrafët 64-67], që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Osmani.

¹⁹ Shitja e të cilit shërben më pas për shlyerjen e huas ndaj shoqërisë “{***}” ShPK.

23.2. Komisioni, për pagesat e vitit 2007, në vendim ka paraqitur problematikë vetëm sa i përket shumës 500.000 lekë të paguar me mandatarë të nr. {***}, datë 19.02.2007²⁰, të pretenduar me burim nga kursimet e vitit 2006. Nga analizimi i deklaratave të interesave privatë të vitit 2006 dhe 2007 të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes M. M., sa i përket kursimeve në *cash*, rezultojnë të jenë deklaruar si vijon.

23.2.1. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006: (i) subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Kursime nga paga dhe të ardhurat familjare (cash), 700.000 lekë, pjesa takuese: 1/2*; (ii) bashkëshortja M. M. deklaroi: *700.000 lekë kursime nga të ardhurat nga paga, pjesa takuese: 1/2*.

23.2.2. Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007: (i) subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Kursime nga paga vetjake dhe bashkëshortit dhe të ardhurat familjare 200.000 lekë, pjesa takuese: 1/2 [...]. Shtesë gjendje cash për vitin 2007, në vlerën 200.000 lekë, pjesa takuese: 100 %*; (ii) bashkëshortja M. M. deklaroi: *Kursime nga paga personale dhe e bashkëshortit, në vlerën 200.000 lekë, pjesa takuese: 1/2*.

23.3. Ashtu siç pretendon subjekti i rivlerësimit në ankim, balanca negative e vlerësuar nga Komisioni në vitin 2007 vjen si pasojë e mosdeklarimit në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007 të pakësimit të gjendjes *cash* të vitit 2006 e lidhur edhe me faktin se në analizën financiare të vitit 2007 Komisioni pasqyron kursime të vitit vlerën 900.000 lekë, pra, duke mbledhur kursimet në *cash* të deklaruara në vitin 2006 dhe ato të deklaruara në vitin 2007, respektivisht 700.000 lekë dhe 200.000 lekë. Shlyerjen e këstit prej 500.000 lekësh, më datë 19.02.2007, me kursimet e vitit 2006, subjekti nuk e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë *vetting*, por në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, deklarata që duhet të përdoret si provë, në kuptim të nenit 32, pika 5 të ligjit nr. 84/2016, e në të cilën subjekti ka deklaruar: *“Blerje apartament banimi me sip. 98 m² [...] e justifikuar si më poshtë: 2.000.000 lekë kredi te BKT; 500.000 lekë tërheqje depozite nga ‘Raiffeisen Bank’, në vitin 2007; 500.000 lekë kursimet e vitit 2006; si dhe 800.000 lekë nga kontrata e huas shkurt 08”*.

23.4. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti sqaron se kursimi familjar në vlerën 200.000 lekë, në deklaratën periodike të vitit 2007, nuk përbën shtesë, por gjendjen *cash* të mbetur nga kursimet e vitit 2006, pas shumës 500.000 lekë të përdorur për shlyerjen e një pjese të çmimit të blerjes së banesës në Korçë, sipas kontratës së porosisë datë 15.02.2007 dhe sipas mandatarë të nr. {***}, datë 19.02.2007. Në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka pasur kursime në *cash*. Subjekti pretendon se nëse do të kishte gjendje *cash* në vlerën 900.000 lekë, atëherë nuk do të kishte pasur nevojë për të marrë hua në muajin shkurt 2008, në masën 800.000 lekë.

23.5. Në kushtet kur analiza financiare e kryer në Kolegj ka treguar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për krijimin e kursimeve në masën 700.000 lekë të deklaruara në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, pretenduar se kanë shërbyer në vitin 2007 për shlyerjen e pagesës 500.000 lekë, më datë 19.02.2007, edhe pse nuk është deklaruar si pakësim në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, është

²⁰ Shoqëria “{***}” ShPK, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 27.11.2019, informon mbi pagesat e kryera dhe vë në dispozicion dokumentacionin financiar [mandatarë të nr. {***} dhe transfera bankare]: i. mandatarë të nr. {***}, datë 15.02.2007, shuma 500.000 lekë; ii. mandatarë të nr. {***}, datë 19.02.2007, shuma 500.000 lekë; iii. Gjendje llogarie BKT, dega Korçë në të cilën rezultojnë e transferuar shuma 1.980.399 lekë me emërtimin “Niko Rapi xhiruar këst për blerje apartamenti, [...]”; iv. mandatarë të nr. {***}, datë 18.02.2008, shuma 800.000 lekë.

deklaruar një vit më pas në deklaratën e interesave privatë të vitit 2008, duke ndrequr kështu pasaktësinë e vitit 2007. Duke i dhënë cilësinë e provës deklaratës së interesave privatë 2008, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe referuar qëndrimin të mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën e tij, sjellë si pretendim nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se provohet fakti që shuma 500.000 lekë është paguar me kursimet e deklaruara në vitin 2006 e, në këto kushte, nuk do të rezultonte pamjaftueshmëria në vlerën 405.000 lekë në vitin 2007 e konstatuar nga Komisioni.

24. Lidhur me mundësinë për dhënien hua të shumës 800.000 lekë nga shtetasi Sh. M., subjekti pretendon në ankim se: (i) *Komisioni duhej minimalisht të arsyetonte kuadrin ligjor të ushtrimit të aktivitetit bujqësor si fermer, i provuar që është ushtruar si aktivitet fitimprurës jo vetëm për nevoja vetjake. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në jurisprudencën²¹ e tijm lidhur me kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016;* (ii) *Nga Komisioni lihet jashtë vëmendjes dhe i paarsyetuar fakti që të vetëpunësuarit në bujqësi, si prodhues të prodhimeve bujqësore, e kanë të pamundur të kenë dokumentacion, i cili të vërtetojë sasinë e prodhimit dhe të ardhurat nga prodhimet bujqësore, si të ardhura të patatueshme. Subjekti i rivlerësimit pretendon se provohet e konfirmuar nga institucionet përkatëse se pagesa e kontributeve është 29.7 % e të ardhurave. Subjekti i rivlerësimit është referuar në dy vendime²² të Komisionit, ku sipas tij janë pranuar si të ardhura të ligjshme, ato të cilat për shkak të gjendjes së legjislacionit tatimor nuk ishit të deklarueshme dhe të tatueshme. Trupi gjykues, në vlerësim të këtyre pretendimeve, konstaton si vijon.*

24.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se shuma 800.000 lekë buron nga kontrata e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.02.2008, lidhur ndërmjet huamarrësit Niko Rapi dhe huadhënësit Sh. M. (i ati i bashkëshortes M. M.). Sipas kontratës, huaja do të shlyhet duke paguar çdo vit më datë 15 shkurt një shumë prej 100.000 lekësh, maksimumi me afat shlyerjeje për 10 vjet. Për pagimin e kësteve dhe deri në shlyerjen përfundimtare, për shkak të raporteve familjare dhe të mirëbesimit, nuk është mbajtur dokument shkresor. Huaja është shlyer për 5 vjet, në periudhën 2008-2012 është paguar çdo vit kësti i parashikuar 100.000 lekë dhe në vitin 2013 është shlyer pjesa e fundit prej 300.000 lekësh, likuidime në *cash*, me kursime nga paga. Marrjen e kësaj huaje subjekti i rivlerësimit e deklaroi dhe në deklaratën periodike të vitit 2008, ndërsa në deklaratat periodike 2008-2012, subjekti i rivlerësimit deklaroi *pagimin e këstit vjetor si detyrim që rrjedh nga kontrata e huas ndaj shtetasit Sh. M. e lidhur më datë 14.02.2008* dhe në deklaratën periodike të vitit 2013, deklaroi pagimin e diferencës së detyrimit të mbetur prej 300.000 lekësh.

24.2. Sa i përket burimit të krijimit të shumës 800.000 lekë të huadhënësit Sh. M., subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit standard, ashtu si dhe bashkëshortja e tij në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 21.10.2019, sqaron se vlera 800.000 lekë është rezultat i aktivitetit bujqësor të prindërve të bashkëshortes, si të vetëpunësuar në bujqësi. Kjo familje është trajtuar me tokë bujqësore nëpërmjet AMTP-së nr. {***}, datë 09.08.1994, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, "Për tokën". Referuar dokumentacionit rezulton se sipërfaqja e tokës e përfituar nga familja e shtetasit Sh. M. është 10,822 m², ku një pjesë është shfrytëzuar si serrë, duke mbjellë prodhime bujqësore të shitura më pas në mënyrë ambulatorie, duke përfituar kështu të ardhura, të cilat kanë qenë të patatueshme. Në mbështetje të argumenteve të tij,

²¹ Shih vendimet nr. 20/2019, paragrafët 31 dhe 63, nr. 15/2019, paragrafi 101, si dhe nr. 32/2018, paragrafi 48.8.

²² Shih vendimin nr. 191, datë 26.07.2019 dhe vendimin nr. 104, datë 17.02.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

subjekti i rivlerësimit ka depozituar dhe disa akte shkresore²³.

24.3. Komisioni me rezultatet e hetimit ka konstatuar se huadhënësi nuk ka pasur tërheqje të vlerave të përafërta të shumës së dhënë hua rreth datës 14.02.2008, madje në datën 03.03.2008 shtetasi Sh. M. ka depozituar dhe rritur depozitën ekzistuese në “Raiffeisen Bank”²⁴ ShA me 1.000.000 lekë. Sipas Komisionit, deklarimet e subjektit mbi burimin e ligjshëm të krijimit të huas 800.000 lekë, nuk janë shteruese, pasi nuk mbështeten në dokumente dhe informacion mbi të ardhurat faktike të huadhënësit, por mbi informacione të supozuara lidhur me qarkullimin e mundshëm nga ky aktivitet, nëse situata e prodhimit do të kishte rendiment 100 %, përfshi dhe faktin se aktiviteti i përmendur ka edhe shpenzime lidhur me investime të nevojshme. Për këtë arsye, sipas Komisionit *mbetet e paprovuar se sa kanë qenë fitimet e familjes nga ky aktivitet, nga të cilat duhen zbritur minimumi i shpenzimeve jetike dhe gjendjet në llogaritë bankare të huadhënësve.*

24.4. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se huadhënësi dhe bashkëshortja kanë paguar rregullisht kontributet e sigurimeve shoqërore si të vetëpunësuar në bujqësi, si dhe kanë shlyer taksën e tokës bujqësore. Referuar legjislacionit për sigurimet shoqërore të vetëpunësuarit në bujqësi duhet të plotësojnë disa kushte: (a) *të mos jenë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë;* (b) *të kenë tokë bujqësore në pronësi, ose në përdorim;* (c) *të ushtrojnë aktivitetin bujqësor dhe blegtoral;* (ç) *të jenë banorë në rrethin që kanë tokë dhe ushtrojnë aktivitetin,* kushte të plotësuara nga prindërit e bashkëshortes. Të ardhurat nga të vetëpunësuarit në bujqësi nuk janë të tatueshme, në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Nga përllogaritja e të ardhurave nga paga minimale e prindërve të bashkëshortes për periudhën 1993-2007 rezultojnë në total shuma 2.686.560 lekë, nga ku huaja në vlerën 800.000 lekë përbën vetëm 29.7 % të kësaj shume. Duke marrë për bazë pagën minimale, sipas viteve dhe një përllogaritje bazë të minimumit jetik për periudhën 1993-2007, niveli i kursimit rezultojnë në shumën 1.288.691 lekë, e cila justifikon burimin e huas në shumën 800.000 lekë. Sipas subjektit të rivlerësimit një sipërfaqe prej 7,000 m² tokë është shfrytëzuar *si serrë*, duke u mbjellë me prodhime bujqësore, duke siguruar të ardhura të konsiderueshme nga shitja e produkteve, kjo për shkak edhe të periudhës më të hershme të daljes në treg. Të ardhurat e familjes, si nga aktiviteti bujqësor i prindërve të bashkëshortes, ashtu edhe nga ato të sjella nga vëllai i saj ndër vite, si rezultat i punës si emigrant ekonomik, rezident në Itali, kanë qenë të mjaftueshme që në gjendjen e llogarisë së huadhënësit, që administronte dhe të ardhurat nga puna në emigracion të kumatit, të derdhej vlera 1.000.000 lekë, më datë 03.03.2008.

24.5. Komisioni në vendim arriti në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të konsiderohet si dokumentacion justifikues për ligjshmërinë e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, duke mos provuar mundësinë

²³ 1. Vërtetim nr. {***} prot., datë 18.03.2019, nr. {***} prot., datë 22.10.2019 dhe nr. {***} prot., datë 22.10.2019 i Njesisë Administrative Maminas; 2. Vërtetim nr. {***} prot., datë 25.03.2019, i Agjencisë Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë; 3. Certifikatë e Regjistrimit të personit të tatuësëm fermer “Sh. H. M.” NIPT {***}, datë e lëshimit 28.03.2019; 4. Vërtetim nr. {***} prot., datë 18.03.2019, i Njesisë Administrative Maminas; 5. Shkresë nr. {***} prot., datë 14.11.2019, e INSTAT, drejtuar znj. M. M.; 6. Vërtetime lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, ku rezultojnë se Sh. H. M. dhe bashkëshortja e tij S. R. M., figurojnë të siguruar si të punësuar në bujqësi nga viti 1993; 7. Shkresë nr. {***} prot., datë 10.01.2019, e ZVRPP- së Durrës; 8. Shkresë nr. {***} prot., datë 29.10.2019 e INSTAT; 9. Vërtetim nr. {***} prot., datë 16.08.2016, i Njesisë Administrative Maminas; 10. Relacion nr. {***} prot., datë 27.01.2020, i Njesisë Administrative Maminas, në të cilin përcaktohet se Sh. M. ka dy sera plastmase me sipërfaqe totale 7,144 m² për kultivim perimesh të ndryshme, duke krijuar të ardhura stabël gjatë viti dhe ndër vite, të ardhura neto përllogariten në vlerën 1.744.565 lekë/vit.

²⁴ “Raiffeisen Bank” ShA që nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 04.02.2020, informon se Sh. M. ka qenë klient i kësaj banke dhe më datë 03.03.2008 ka kredituar llogarinë e tij me shumën 1.000.000 lekë.

financiare të babait të bashkëshortes së subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhënien e huas në vitin 2008.

24.6. Në linjë me Komisionin, trupi gjykues konstaton se të ardhurat nga bujqësia për periudhën 1993-2007, nuk u provuan me dokumentacion justifikues ligjor të kohës. Për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të shumës së dhënë hua, në vlerën 800.000 lekë, nga personi tjetër i lidhur, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion provues asnjë të ardhur të realizuar nga vetëpunësimi në bujqësi i huadhënësit Sh. M. për këtë periudhë dhe as të ardhura të shtetasit S. M. nga punësimi në Itali prej vitit 1998. Fakti që shtetasi Sh. M. ka përfituar tokë arë në zbatim të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, është i provuar, po kështu janë konfirmuar dhe shlyerja e taksës vendore të tokës ndër vite nga njësia administrative vendore, por këto dy elementë jo domosdoshmërisht provojnë që toka është shfrytëzuar dhe ka prodhuar të ardhura. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të huas në vlerën 800.000 lekë, duke konsideruar kështu të drejtë konstatimin e Komisionit, por i udhëhequr nga parimi *reformatio in peius*, Kolegji nuk mund të përkeqësojë situatën e subjektit të rivlerësimit, në kushtet kur Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, pamundësinë për të provuar realisht mundësitë financiare të huadhënësit, për të mbuluar me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, për dhënien e huas në shumën 800.000 lekë, nuk e ngriti në shkak të mjaftueshëm për ta kualifikuar si mangësi, në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, në pamjaftueshmëri në deklarin e pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 të këtij ligji.

24.7. Në përfundim të sa sipërsyrtuar, duke mos e konsideruar huan në shumën 4.000.000 lekë dhënë subjektit të rivlerësimit nga shoqëria “{***}” ShPK, në kushtet e trajtimit preferencial apo konfliktit faktik të interesit, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë si parashikuar nga neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

- 25.** Lidhur me çështjet e tjera të cilat kanë çuar në shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, konkretisht sa i përket përdorimit të automjetit në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK dhe raportit të subjektit me avokatin A. Z., Kolegji i ka trajtuar në kuadër të vlerësimit tërësor të parashikuar nga neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke i ndarë nga vlerësimi në kuadër të kriterit të pasurisë.
- 26.** Lidhur me përdorimin e automjetit me targë {***}, në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti pretendon se: (i) Komisioni nënvlerëson pa asnjë arsytim në vendim dhe pa vlerësuar me provat e tjera shkresore deklaratën noteriale të shtetasit L. B, që në cilësinë e administratorit të shoqërisë konfirmon dorëzimin fizik të këtij mjeti ditën e redaktimit të aktit noterial; (ii) ndryshe nga sa disponon Komisioni, automjeti është shfrytëzuar vetëm për një udhëtim disa orë nga Pogradeci në Ohër, në muajin qershor 2016, pavarësisht përmbajtjes së prokurës dhe tagrave të përmendura në të. Përcaktimet në këtë akt noterial kanë qenë standarde sa i përket tagrave të dhëna apo shtrirjes kohore; (iii) Komisioni ka pasur detyrë ligjore të jetë më i qartë e të përcaktojë se në cilën periudhë subjekti i rivlerësimit ka përdorur këtë automjet përveç datës së aktit noterial, datë 04.06.2016, gjë që nuk e ka bërë, duke evidentuar në mënyrë të pasaktë faktin, vetëm nga përmbajtja e aktit noterial; (iv) nga të dhënat e përftuara nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, del një e dhënë domethënëse që provon se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë raport të caktuar me këtë mjet, përveç përdorimit disa orësh të tij më datë 04.06.2016; (v) subjekti i rivlerësimit pretendon se përmbajtja e aktit noterial në lidhje me të dhënat e dala nga provat e tjera shkresore, duke i parë në tërësi e në unitet me njëra-tjetrën nuk mund të kishte përfundim tjetër përveç vullnetit real të pronarit të automjetit për dhënien në përdorim për të shkuar atë ditë në Ohër, si dhe qëllimi i subjektit

nuk ka qenë pajisja me të gjitha tagrat e përmendura në aktin noterial por mbajtja e mjetit vetëm ditën e aktit noterial për një udhëtim të vetëm, duke e dorëzuar atë me kthimin në vend. Nga analizimi i akteve të dosjes dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton si vijon.

26.1. Automjeti me targë {***}, i markës “Land Rover”, referuar dosjes së regjistrimit të vënë në dispozicion të Komisionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 18.05.2020, është blerë për shoqërinë “{***}” ShPK, nga ortaku i saj A. B. me shitës {***}, Mynih, më datë 24.09.2012, në vlerën 28.500 euro. Referuar kësaj shkrese, automjeti rezultoi t’i jetë shitur më datë 28.02.2019, shtetasit D. A..

26.2. Përdorimi i këtij automjeti është deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit standard. Subjekti përmend përdorimin në disa raste të automjeteve në pronësi të shtetasve të ndryshëm, sipas akteve të përdorimit, të cilat nuk i dispononte plotësisht. Subjekti përmend përdorimin e automjetit në pronësi të shtetasit G. Ç., automjet me targë {***}, përdorur nëpërmjet autorizimit për huapërdorje nr. {***} rep., datë 27.02.2010 dhe kontratës së huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.08.2011, automjetin e shtetasit B. Ç., përdorur nëpërmjet kontratës së huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2010 dhe automjetin e shtetasit L. B., përdorur me prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.06.2016. Subjekti i rivlerësimit thekson se në asnjë rast përdorimi i automjeteve prej tij nuk ka zgjatur më tepër se 24 orë. Në raste të tjera për në Ohër, Maqedoni e Veriut, ka udhëtuar me shërbim taksit ose me mjete të rastit, pasi automjetit në pronësi të tij, në këtë periudhë, nuk i ishte prerë asnjëherë siguracion për jashtë shtetit, për shkak të gjendjes jo të mirë teknike.

26.3. Lidhur me udhëtimet jashtë shtetit, subjekti, ndër të tjera, shprehet se në datën 04.06.2016 ka kryer vizitë njëditore (vajtje-ardhje), në Ohër, Maqedoni e Veriut, së bashku me bashkëshorten M. M. dhe vajzën S. R., ku sqaron se ka përdorur vetëm për këtë ditë automjetin e shtetasit L. B., mik i familjes, duke paraqitur edhe prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.06.2016, të shoqërisë “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori L. B.. Nëpërmjet kësaj prokure i përfaqësuari i jep shtetasit Niko Rapi, tagrat e përfaqësimit që të veprojë në emër dhe për llogari të të përfaqësuarit, *ta përdorë, ta blejë, ta shesë, ta dhurojë, vetes ose personave të tretë, ta përdori automjetin [...] për nevojat e tij brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në të gjitha vendet e Bashkimit Europian, [...] për një periudhë të pacaktuar kohe dhe duhet të përkujdeset për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e përditshme dhe periodike të automjetit.*

26.4. Në këto kushte, Komisioni i kalon barrën e provës subjektit të rivlerësimit, se përse nuk ka deklaruar në deklaratat e interesave privatë periodikë përdorimin e automjetit, duke shprehur në të njëjtën kohë dhe paqartësinë se për cilën arsye shoqëria “{***}” ShPK do të jepte në posedim pa kushte automjetin, një personi privat që s’ka asnjë lidhje me shoqërinë, pa llogaritur interesin. Në vlerësim të Komisionit, subjekti duhet të shpjegonte nëse fakti që një gjyqtar, një kryetar gjykate, merr një hua të konsiderueshme nga një shoqëri private dhe posedon një automjet të konsiderueshëm në zotërim nga e njëjta shoqëri, përbën një konflikt interesash, në kuptim të ligjit nr. 9637/2005 dhe Kodit të Procedurave Administrative.

26.5. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit sqaron se këtë mjet e ka përdorur vetëm për një udhëtim disa orësh nga Pogradeci në Ohër, Maqedoni e Veriut dhe pavarësisht përmbajtjes së prokurës dhe të tagrave të përmendura në të, qëllimi i tij nuk ka qenë të marrë një mjet të regjistruar në emër të kompanisë “{***}” ShPK, por në ditën që i duhej të lëvizte për në Ohër (04.06.2016) i është drejtuar shtetasit L. B., i cili ka vlerësuar t’i vërë në dispozicion këtë mjet, me aktin noterial të realizuar po këtë ditë. Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna, subjekti i rivlerësimit i referohet dhe një akti tjetër të ngjashëm prokurë nr. {***}

rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2015, në të cilën tagrat e dhëna janë tërësisht të njëjta me ato në prokurën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.06.2016, me të cilin është pajisur subjekti i rivlerësimit. Automjeti, sipas subjektit, i është dorëzuar administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, që në momentin e kthimit. Sa i përket deklarimit të përdorimit të automjetit në deklaratën e interesave privatë, subjekti referon dallimin mes mbajtjes së thjeshtë të sendit, si në rastin konkret dhe posedimit të parashikuar në nenin 304 të Kodit Civil dhe në doktrinën juridike si institut që paraqitet si një gjendje fakti që lidhet me kontrollin fizik mbi një send, aktivitet ky i shtrirë në kohë të arsyeshme, i shoqëruar me vullnetin dhe dëshirën për të ushtruar kontrollin fizik, ku të gjithë personat e tjerë konsiderohen të zhveshur nga posedimi dhe nga të drejtat reale të tij. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit paraqet deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2020, të shtetasit L. B., i cili deklaron se: “[...] automjeti me targë {***} nga ana e shtetasit Niko Rapi është përdorur vetëm ditën e prokurës, datë 04.06.2016 dhe që nga ajo ditë ka qenë në përdorim të pandërprerë të shoqërisë {***}’ ShPK, deri në momentin e shitjes”.

26.6. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk e ka bazuar konkluzionin e tij në paragrafin 6.13 të vendimit të kohëzgjatja e përdorimit nga subjekti të automjetit të shoqërisë “{***}” ShPK, për të cilin subjekti ka pretenduar se e ka mbajtur vetëm disa orë. Edhe pse prokura e posaçme i njeh subjektit të rivlerësimit një sërë tagrash mbi këtë automjet dhe për një kohë të pacaktuar, pretendimet e subjektit të rivlerësimit harmonizohen me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2020, të shtetasit L. B. dhe provat e tjera të administruara në dosjen gjyqësore, ku sipas të dhënave të sistemit TIMS për subjektin dhe bashkëshorten e tij, rezulton se ky automjet është përdorur vetëm më datë 04.06.2016, dalje nga pika kufitare Tushemisht ora 10:54 dhe hyrje në të njëjtën pikë më 17:42 dhe më pas të jetë përdorur nga shtetasi A. B., ortak i shoqërisë “{***}” ShPK. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e trajtimit preferencial nga shoqëria “{***}” ShPK, për faktin e përdorimit brenda një dite të automjetit në pronësi të saj.

26.7. Në analizë të kësaj çështjeje, trupi gjykues konstaton se në periudhën kur subjekti i rivlerësimit ka përdorur automjetet e shtetasve të tjerë G. Ç. dhe B. Ç. ka pasur në pronësi të tij automjetin “Mercedes Benz”, të përfutur me kontratë shitblerje më datë 21.08.2005, si dhe automjetin në dispozicion të gjykatës për periudhën kohore 22.04.2008 -11.10.2015. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për gjendjen jo të mirë teknike të automjetit të tij, apo arsyeja e përdorimit të automjeteve të tjera, nuk justifikojnë shkujdesjen e veprimeve të tij për përdorimin e automjeteve me vlerë të konsiderueshme, në pronësi të shtetasve që njihen në komunitet si persona me influencë, duke bërë që veprimet e subjektit të rivlerësimit të duken sikur komprometojnë sjelljen e gjyqtarit e duke krijuar perceptimin e përfitimeve për shkak të detyrës.

- 27.** Lidhur me shpenzimet e udhëtimit në mars 2011, subjekti pretendon se: (i) Komisioni nuk ka argumentuar nëse mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit të subjektit të rivlerësimit në mars të vitit 2011, në Gjermani, është bërë nga shoqëria “{***}” ShPK, ku në mënyrë kontradiktore me analizën e tij financiare i atribuon subjektit të rivlerësimit faktin se këto shpenzime udhëtimi i janë mbuluar nga shtetasi L. B., çka përbën një fakt të paqenë, të paprovuar dhe që rëndon dukshëm padrejtësisht pozitën e subjektit në vështrim të “trajtimit preferencial” prej një individi/shoqërie; (ii) Komisioni, kërkon që subjekti të paraqesë prova e ta bindë për të kundërtën e konstatimit se shpenzimet e këtij udhëtimi ia ka mbuluar një person tretë, në kushtet e një trajtimi më tepër se miqësor. Në mënyrë të logjikshme e të natyrshme, për shkak të natyrës së këtyre shpenzimeve, subjekti i rivlerësimit është i justifikuar të mos ketë asnjë lloj akti e prove për atë që pretendon Komisioni e për të kundërshtuar qoftë dhe formalisht gjetjen e tij, iii. Pavarësisht kohës së gjatë që ka kaluar, subjekti i rivlerësimit ka bërë të gjitha përpjekjet

*e nevojshme për komunikimin me shoqërinë ajrore “{***}”, për të provuar elementët e pagesës së udhëtimit, duke vlerësuar se ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive të parashikuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, në analizë të këtyre pretendimeve, konstaton si vijon.*

27.1. Përveç pretendimit të ngritur për situatën e konfliktit të interesit, në denoncimin anonim nr. {***} prot., datë 04.03.2020, denoncuesit pretendojnë se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë vendit për të parë ndeshje futboll, me persona me influencë, me deputetë dhe për këtë kërkojnë që të hetohet. Komisioni në vendim ka bashkuar udhëtimin me situatën e konfliktit në dukje të interesit, marrjen e huas, përdorimin e automjetit dhe ka vlerësuar se tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit tregojnë një raport të tillë të përkujdesjes së subjektit të rivlerësimit me zbatimin e ligjit, të papranueshëm për të pasur besimin e publikut. Në vlerësim të Komisionit rëndësia e sjelljes jashtë gjyqësore të gjyqtarit dhe ndikimi i saj në besimin e publikut të sistemi i drejtësisë është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri, Kodit të Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, sipas së cilave shkelja e ligjit nga një gjyqtar, jo vetëm dëmton reputacionin e funksionit si gjyqtar, por inkurajon mosrespektimin e ligjit dhe cenon besimin e publikut në integritetin e gjyqësorit, në kushtet kur sjellja e gjyqtarit duhet të ishte e denjë dhe të mos ngriheshin perceptime favorizimi apo përfitime për shkak të pozicionit, në sytë e publikut. Rrethana këto të cilat i ka konsideruar të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “d” dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

27.2. Faktin e udhëtimit në datat 14.03.2011-16.03.2011, në Mynih, Gjermani, për të parë ndeshjen Bayern Mynih-Inter, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar vetë në përgjigjet e pyetësorit standard se ka udhëtuar me mikun e tij L. B. nëpërmjet linjës ajrore nga Selanik, Greqi për në Mynih, Gjermani, si dhe në shoqërinë e K. M., dalë nga pika e kalimit kufitar Kapshticë me automjetin e këtij të fundit, i cili ka lidhje të afërt miqësore me shtetasin L. B.. Sa i përket shpenzimeve për këtë udhëtim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se bileta e udhëtimit për linjën ajrore Selanik-Mynih ka shkuar rreth 130 euro, në total shpenzimet rreth 300 euro.

27.3. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e dërguara me e-mail-in e datës 25.03.2020, është shprehur se në Mynih, Gjermani, ka qenë me shtetasin L. B., i cili ka udhëtuar dy ditë më parë, si dhe me shtetasin K. M., njohje dhe lidhje shoqërore e shtetasit L. B., me mjetin e shtetasit K. M.. Me të njëjtin mjet, për të njëjtin destinacion, kanë qenë edhe shtetasit A. M. (djali i K.) dhe A. Z.. Sipas subjektit të rivlerësimit është ndjekur linja ajrore e udhëtimit Selanik-Mynih, duke udhëtuar deri në Selanik me automjet për shkak të kostos më të ulët në krahasim me linjën ajrore Tiranë-Mynih. Lidhja shoqërore e miqësore, sipas subjektit të rivlerësimit në këtë udhëtim, ka qenë vetëm me shtetasin L. B.. Me prenotimin e biletave të avionit është marrë shtetasi K. M., ndërsa me hotelin dhe me biletat e hyrjes në stadium për shumë persona, përfshirë subjektin, shtetasin L. B., personat me të cilët ka udhëtuar subjekti i rivlerësimit është angazhuar kushëriri i parë i shtetasit L. B., D. B., që jeton prej vitit 1990, në Mynih, Gjermani. Çdo lloj pagese, sipas subjektit, është bërë prej tij kundrejt personit që e ka kryer. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, sqaron se personat nga grupi i udhëtimit nuk janë “njerëz me influencë” dhe nuk mban përgjegjësi për personat që mund të gjenden në stadium. Terminologjia e përdorur në denoncim nuk duhet të merret në konsideratë në procesin e rivlerësimit për një subjekt rivlerësimi, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi është tendencioze, pa asnjë bazë dhe e pasaktë.

27.4. Ndërsa në lidhje me mbulimin e shpenzimeve të këtij udhëtimi, subjekti i rivlerësimit sqaron se ato janë deklaruar në funksion të pyetësorit standard nga ai dhe nga bashkëshortja si

subjekt deklarues. Gjendja e likuiditeteve në vitin 2011 e mundësonte mbulimin e këtij shpenzimi, referuar dhe analizës financiare të Komisionit. Subjekti, gjithashtu, sqaron se në asnjë moment të karrierës së tij prej 19 vitesh, si gjyqtar nuk ka lejuar persona të ndryshëm të mbulojnë çdo lloj shpenzimi të tij, qoftë edhe minimal (pra, larg kufirit për t'u trajtuar preferencial), rrethanë që do ta vinte në një situatë të konfliktit në dukje të interesit.

27.5. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 11.06.2020, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për informacion lidhur me çështjet gjyqësore që mund të jenë shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, me palë ndërgjygjëse shoqëritë {***} ShA, “{***}” ShPK, “A. B.”, person fizik, me datë regjistrimi 30.03.2011, me aktivitet, investitor për shitblerjen e banesave apo me shtetasit K. M.²⁵, A. B. dhe I. B.. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, me shkresën nr. {***} prot., datë 16.06.2020, informon se z. Niko Rapi, për periudhën e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit pranë kësaj gjykate, nuk rezulton të ketë gjykuar si gjyqtar i vetëm apo si anëtar i trupit gjykues me këto subjekte.

27.6. Në mbështetje të situatës së parashtruar më sipër, pavarësisht se Komisioni ka dyshuar se shpenzimet e udhëtimit të subjektit të rivlerësimit janë mbuluar nga shtetasi L. B., apo nga ndonjë bashkëudhëtar tjetër në këtë udhëtim, fakt i përmendur dhe nga vëzhguesja ndërkombëtare gjatë seancës dëgjimore, ndërkohë që nga aktet në dosje nuk rezulton asnjë e dhënë mbi pagesën e këtyre shpenzimeve nga subjekti i rivlerësimit apo dikush tjetër, këto shpenzime Komisioni i ka përfshirë në analizën e tij financiare të vitit 2011 në zërin “shpenzime TIMS”. Duke marrë në konsideratë rrethanat se: (i) nuk provohet kush e ka kryer pagesën për këtë udhëtim të subjektit të rivlerësimit; (ii) në denoncim nuk ngrihet si pretendim fakti i pagesës së shpenzimeve nga të tretë, por që *udhëtimi është kryer me njerëz me influencë*; (iii) si dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare në atë periudhë për të mbuluar vetë shpenzimet e këtij udhëtimit, në vlerësim të Kolegjit, e lënë të paprovuar faktin e mbulimit të shpenzimeve nga të tretë, si një trajtim preferencial.

- 28.** Lidhur me raportin e subjektit të rivlerësimit me avokatin A. Z., subjekti i rivlerësimit ka ngritur këto pretendime: (i) *Komisioni nuk ka ngritur problematikë apo dyshim për ndikim ose njëanshmëri lidhur me vendimet e subjektit në çështjet gjyqësore në të cilat z. A. Z. ka qenë avokat i palës, në periudhën nëntor 2010 - nëntor 2016; (ii) Konkluzioni i Komisionit rezulton i gabuar, pasi nuk janë hetuar një sërë rrethanash, si fakti që raporti mes gjyqtarit dhe avokatit ka qenë i një shkalle njohjeje zakonshme, aspak në nivelin miqësor, njohje përpara se z. Z. të ushtronte profesionin e avokatit dhe përpara udhëtimit në mars 2011 si element i vetëm i sjellë si provë; (iii) Komisioni ka anashkaluar fakte të tilla si: (a) nuk është kërkuar asnjëherë përjashtimi si gjyqtar nga pala kundërshtarë në të gjitha proceset e zhvilluara në periudhën 2011-2016; (b) nuk ka asnjë ankesë në rrugë administrative në periudhën 2011-2016, pranë Inspektoratit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nga ndonjë individ, subjekt tjetër procedural që të ngrinte qoftë dyshimin më të vogël për sjellje të njëanshme të subjektit të rivlerësimit kundrejt avokatit; (c) avokati nuk ka pasur asnjë raport të veçantë apo trajtim të diferencuar pozitiv nga subjekti, i cili në dy raste ka kërkuar nisjen e procedimit disiplinor ndaj avokatit. Trupi gjykues, në analizë të këtyre pretendimeve, konstaton si vijon.*

28.1. Komisioni në vendim arrin në konkluzionin se marrëdhënia personale dhe miqësore e subjektit të rivlerësimit me shtetasin A. Z., duhet të ishte e kufizuar në respektim të ushtrimit të detyrës së tij, pasi fakti se ushtronte funksionin e avokatit dhe se shpesh mund të përballeshin në procese gjyqësore, mund të krijonte një perceptim të gabuar te publiku dhe qytetarët e Pogradecit. Komisioni referon këtu pikën 4.9 të Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, që parashikon se: “Një gjyqtar nuk duhet të përdorë apo të cenojë prestigjin e postit të gjyqtarit

²⁵ Aksioner i shoqërive {***} ShA dhe “{***}” ShPK.

për interesa private të tij apo të një anëtarit të familjes së tij, apo të kujt do tjetër, dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen apo të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se kushdo me pozitë të veçantë ndikon padrejtësisht në punën e tij gjatë ushtrimit të profesionit”. Situatë ligjore dhe faktike kjo, parë në vlerësimin tërësor, në zbatim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe në kuptim të pikës 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, çon në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut.

28.2. Në denoncimin anonim, që ka çuar dhe në rifillimin e hetimit administrativ, janë përmendur *udhëtime apo influenza sa djathtas e majtas, me deputetë që ka udhëtuar për të parë ndeshje futbollit jashtë shtetit.* Në këtë denoncim, trupi gjykues konstaton se nuk përmenden emra personash konkretë me influencë. Shtetasi A. Z., përmendet nga vetë subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e datës 25.03.2020, ku ka deklaruar se në udhëtimin për të ndjekur ndeshjen në Mynih, në të njëjtin mjet, për të njëjtin destinacion, kanë qenë përveç shtetasve K. M. dhe A. M. (djali i K.) dhe shtetasi A. Z.. Referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar të personit fizik “A. Z.”, rezulton të jetë regjistruar më datë 27.10.2010, për veprimtari në fushën e avokatisë, përfaqësime ligjore, ndërmjetësim etj.

28.3. Në raportin e rezultateve të hetimit administrativ, seksionin “Gjetje të tjera”, Komisioni ka evidentuar se, me autorizim për huapërdorje nr. {***} rep., datë 27.02.2010, huadhënësi G. Ç. i jep për një afat 10-ditor huapërdorësit Niko Rapi, automjetin e markës “Volvo”, me targë {***}. I njëjti automjet i kalohet përsëri subjektit të rivlerësimit, me kontratë huapërdorje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.08.2011, për një afat 1-vjeçar. Ndërsa me kontratë huapërdorje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2010, huadhënësi B. Ç. i jep për një afat 1-vjeçar huapërdorësit Niko Rapi automjetin e markës “KIA”, me targë {***}. Siç rezulton e pasqyruar në rezultatet e hetimit, Komisioni ka vënë re se shtetasit G. Ç. dhe B. Ç. janë vëllezër. Shtetasi B. Ç. është kryetar i Partisë Socialiste dega Pogradec dhe nënkryetar i Bashkisë Pogradec. Subjekti i rivlerësimit duket se udhëton me makinat e këtyre shtetasve.

28.4. Komisioni, gjithashtu, ka konstatuar se: *“Nga sistemi TIMS dhe deklarimet e subjektit rezulton se ai udhëton edhe me shtetasin A. Z. – avokat në Z. Studio Ligjore në Pogradec dhe i përfshirë në aktivitete politike në Qytetin e Pogradecit. Sipas disa të dhënave në portale thuhet se A. B. ka një denoncim për Gjykatën e Pogradecit. Korrupsion i paparë këtu në Gjykatën e Pogradecit, vendime gjyqësore, për punonjësit e larguar nga puna, sekseri av. A. Z., ju premtori fitoren me gjyqësorin, kundrejt shpërblimit. Vetëm ish-drejtori i Ujësjellësit ka fituar gjyqin me një vlerë 45 milionë lekë [...]”.* Në këtë raport, sa i përket përdorimit të automjeteve në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, G. Ç. dhe B. Ç., si dhe udhëtimet me A. Z., Komisioni i kërkon shpjegime subjektit të rivlerësimit.

28.5. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se qëllimi i marrjes së mjeteve në përdorim ka qenë vetëm nevoja për të lëvizur brenda ditës në Maqedoninë e Veriut, duke qëndruar në Ohër dhe pavarësisht afatit të përcaktuar në aktet noteriale automjetet në fjalë janë përdorur vetëm brenda ditës dhe maksimumi deri të nesërmen, duke pretenduar se nuk është treguar i kujdesshëm për të verifikuar përmbajtjen e akteve noteriale. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje një rrethanë të rëndësishme, sipas tij, faktin që akti noterial, autorizim për huapërdorje, datë 28.08.2010, me huadhënës B. Ç. figuron me afat 1-vjeçar, por në fakt brenda këtij afati që përfundonte më datë 28.08.2011 është lidhur kontrata e huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.08.2011, për një periudhë 1-vjeçare, pa mbaruar afati i parë. Kjo rrethanë, sipas subjektit, tregon se asnjëri nga automjetet në fjalë nuk është përdorur prej tij përveçse në një udhëtim njëditor. Këtë rrethanë, sipas subjektit, e tregon data e akteve noteriale dhe të dhënat e sistemit TIMS apo të pasaportave që sqarojnë datën e lëvizjes me këtë mjet në Maqedoni.

28.6. Ndërkohë, sa i përket udhëtimeve jashtë vendit të përcaktuara në përgjigjet e pyetësorit standard, rezulton se subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar: përdorimin e automjetit të shtetasit

G. Ç., më datë 27.02.2010, vizitë njëditore në Ohër, Maqedoni; përdorimin e automjetit të shtetasit B. Ç. më datë 29.08.2010 vizitë njëditore në Ohër, Maqedoni; dhe më datë 01.08.2011 përdorimin e automjetit të shtetasit G. Ç. vizitë njëditore në Ohër, Maqedoni. Ndërsa lidhur me përfshirjen politike të vëllezërve Ç., subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shtetasi B. Ç., në kohën e këtyre akteve noteriale në fjalë, nuk ka pasur asnjë funksion politik, pasi në atë periudhë sapo kishte përfunduar arsimin e lartë, punonte në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk kishte angazhime politike në struktura të larta drejtuese.

28.7. Në lidhje me aktivitetin politik të shtetasit A. Z., subjekti sqaron se me sa ishte në dijeni në atë kohë ky shtetas nuk mbante funksione drejtuese dhe nuk ka qenë faktor ndikues në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit si gjyqtar. Ndërsa pas interesimit të subjektit, ky shtetas e ka informuar se prej shumë vitesh, edhe kur subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, nuk ishte angazhuar në asnjë forcë apo veprimtari politike.

28.8. Në lidhje me denoncimin në portale të shtetasit A. B., subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se këtu flitet për çështjen civile me paditës V. G. dhe se vendimi nr. {***}, datë 12.10.2017, nuk është dhënë nga subjekti i rivlerësimit, i cili është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më 18.11.2016. Subjekti sjell në vëmendje se me vendimin nr. {***}, datë 16.11.2016²⁶, ka pranuar kërkesën e palës së paditur në atë gjykim Ujësjiellës Kanalizime ShA Pogradec, me objekt “Përjashtimin e gjyqtarit”, gjykim ku pala paditëse V. G. ka kërkuar mospranimin e kësaj kërkesë. Subjekti sqaron se çështja gjyqësore e përmendur në denoncimin e shtetasit A. B. është gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, pasi subjekti është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe denoncimi nuk ka asnjë lidhje me ushtrimin e detyrës së tij.

28.9. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.05.2020, i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec për përcjelljen e vendimit dhe/ose fashikullin e plotë gjyqësor të çështjeve të gjykuara nga Niko Rapi, ku njëra palë është përfaqësuar nga avokat A. Z. ose përfaqësues nga zyra avokatore “Z.”. Me shkresat nr. {***} prot., datë 27.05.2020 dhe nr. {***} prot., datë 01.06.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec i vë në dispozicion Komisionit 95 vendimet gjyqësore për çështjet e gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, z. Niko Rapi.

28.10. Lidhur me 95 çështjet gjyqësore e gjykuara, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimmarrja nuk lë vend për të menduar ndonjë trajtim të avantazhuar për shkak të zgjedhjes si mbrojtës të avokatit A. Z. ose avokatët e tjerë të studios së tij ligjore. Subjekti i rivlerësimit ka bërë prezent disa vendime gjyqësore që prej tij është mbajtur i njëjti standard gjykimi, sikurse dhe në të gjitha çështjet e tjera, duke evidentuar rastet gjyqësore, ku subjekti ka vendosur pushimin e gjykimit²⁷, kur ky avokat/studio e tij ligjore mbronin interesat e palës paditëse për shkak të mosparaqitjes së kësaj pale. Subjekti, gjithashtu, sjell në vëmendje vendime të tij në çështje civile, kërkesa me objekt “Përjashtim gjyqtari” dhe çështje penale, duke theksuar se në asnjë rast nuk ka pasur ndonjë trajtim që mund të krijojë dyshimin më të vogël për krijimin e një situatë/trajtimi të favorshëm. Ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit evidenton disa vendime²⁸

²⁶ Me vendimin nr. {***}, datë 16.11.2016, është vendosur “Pranimi i kërkesës së palës kërkuese Ujësjiellës Kanalizime ShA Pogradec, me person të tretë V. G., me objekt “Përjashtim i gjyqtarës L. K. nga shqyrtimi i çështjes civile me paditës V. G., të paditur Ujësjiellës Kanalizime ShA Pogradec, me objekt “Detyrim për pagim page” dhe zëvendësimin e saj me një gjyqtar tjetër sipas procedurave ligjore, me short [...]”.

²⁷ Vendimi nr. {***}, datë 26.09.2013; vendimi nr. {***}, datë 21.05.2015; vendimi nr. {***}, datë 19.01.2016; si dhe vendimi nr. {***}, datë 16.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

²⁸ Vendimi nr. {***}, datë 06.12.2011, i pandehur H. H., dënuar për veprën penale të vrasjes me paramendim, me 1 vit më tepër se kërkesa e prokurorisë; vendimi nr. {***}, datë 09.12.2014, i pandehur H. G., dënuar për veprën penale të mashtrimit në sigurime (neni 145 i Kodit Penal), më tre muaj burgim, kur prokuroria ka kërkuar dënimin me 300.000 lekë gjobë; vendimi nr. {***}, datë 03.05.2016, i pandehur A. D. etj., dënuar për veprën

në të cilët ka disponuar me dënime më të ashpra se sa pretendimet e organit të akuzës, në masë apo lloj dënimi. Subjekti i rivlerësimit përmend gjithashtu një sërë vendimesh²⁹ kur është dhënë e njëjta masë dënimi sa kërkuar nga organi i akuzës, duke mos pranuar pretendimin e mbrojtjes për një masë më të ulët dënimi.

28.11. Nga analizimi i 95 vendimeve gjyqësore të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues vëren se për 40 prej tyre, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit, miratimin e vendimit apo mospranimin e ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, 51 vendime gjyqësore kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar, ndërsa për 3 vendime gjyqësore, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, dhe për një vendim gjyqësor është vendosur pushimi për shkak të heqjes dorë nga ankimi. Nga vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në këto 95 vendime gjyqësore nuk evidentohen elemente njëanshmërie në favor të palës së mbrojtur apo përfaqësuar nga avokat A. Z., për më tepër, kur ndaj këtij avokati, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar dy herë Dhomës së Avokatisë Korçë, për fillimin e procedimit disiplinor.

29. Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, ka pretenduar se: (i) Në vendimin e Komisionit nuk ka asnjë referim në dispozitat e ligjit nr. 96/2016, Kodit të Etikës Gjyqësore të Republikës së Shqipërisë, apo në ndonjë vendim të GJEDNj-së, përveç citimit të pamjaftueshëm të pikës 4.9 të Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore. Në praktikën e Komisionit dhe Kolegjit nuk provohet se situata të tilla të jenë konsideruar dhe interpretuar se përbëjnë veprime apo mosveprime me efekte të rënda në dëmtimin e imazhit e të besimit të publikut të drejtësia, që kanë çuar në zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016; (ii) Një fakt i ndodhur 10 vjet më parë, i papërsëritur, në vështrim të parimeve të pavarësisë, paanshmërisë, integritetit, nuk ka sjellë efekte të vetë palët në proces në atë kohë dhe as më vonë, pra, nuk ka cenuar paanshmërinë në të dyja testet [objektiv, subjektiv] apo as në dukje të besimit të publikut; (iii) Referuar paragrafit 123 të Komentarit të Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore ka vetëm një raport e një shoqërim të padëmshëm për gjyqtarin e për drejtësinë. Udhëtimi, sipas subjektit, nuk ka qenë pengesë për ta çuar avokatin dy herë në procedim disiplinor, si dhe nuk mund të ngrihet as dyshimi më i vogël për cilësinë, ndershmërinë dhe drejtësinë e subjektit të rivlerësimit në 95 vendimet gjyqësore, në të cilat ky avokat ka qenë përfaqësues, në periudhën 2010-2016; (iv) Në jurisprudencën³⁰ e Komisionit, kur subjektet janë ndodhur në kushtet e konfliktit të interesit (marrëdhënie kontraktore, miqësore e shoqërore të hershme, madje në mënyrë të përsëritur), duke mos bërë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, Komisioni i ka vlerësuar me të drejtë konfirmim në detyrë apo dërgim për hetim disiplinor, por jo masa e shkarkimit nga detyra, pasi procesi i rivlerësimit bazohet në parime, si proporcionalitet dhe objektiviteti.

29.1. Trupi gjykues, në analizë të këtyre pretendimeve, vlerëson se pavarësisht përgjegjësisë profesionale gjatë ushtrimit të detyrës nëpërmjet vendimeve të marra prej tij, edhe sjellja e gjyqtarit jashtë zyrës, zë një vend po aq të rëndësishëm. Konkretisht, ky fakt ka marrë rëndësinë e një vlere themelore të magjistratit dhe gjen vend në nenin 3, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, sipas

penale të plagosjes së rëndë (neni 88 i Kodit Penal), ndërsa është dhënë dënim më burgim dhe jo me gjobë dhe fajësi për të gjithë të pandehurit, pavarësisht pretendimeve të mbrojtësve.

²⁹ Vendimi nr. {***}, datë 15.04.2011, e pandehur E. Xh., dënuar për veprën penale të vjedhjes, neni 134/1 i Kodit Penal; Vendimi nr. {***}, datë 01.06.2015, i pandehur G. D. etj., dënuar për veprën penale të vjedhjes, neni 134/2 i Kodit Penal; vendimi nr. {***}, datë 21.09.2015, i pandehur F. B., dënuar për veprën penale të prodhimit e mbajtjes së lëndëve narkotike, neni 283/1 i Kodit Penal; vendimi nr. {***}, datë 27.06.2016, i pandehur G. K., dënuar për veprën penale të dhunës në familje, neni 130/a i Kodit Penal; vendimi nr. {***}, datë 01.09.2016, i pandehur A. Sh., dënuar për veprën penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën, neni 135 i Kodit Penal.

³⁰ Referon vendimet nr. 26, datë 21.06.2018, nr. 273, datë 10.07.2020, nr. 161, datë 18.06.2019, nr. 276, datë 21.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

së cilës sjellja e magistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Në Kodin e Etikës Gjyqësor të datës 08.12.2006, konkretisht në rregullin 15 dhe rregullin 19 përcaktohet se: “Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor, ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore”. “Gjyqtari [...] nuk duhet të krijojë ose të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se ata gjenden në një pozitë të veçantë për të ndikuar mbi gjyqtarin”. Pra, gjyqtari dhe jashtë ushtrimit të funksioneve të tij nuk duhet të ketë sjellje, qoftë edhe të ligjshme, por që cenojnë besueshmërinë personale dhe dinjitetin e tij ose prestigjin e institucionit gjyqësor, pasi përbën shkelje çdo sjellje që cenon pavarësinë, paanshmërinë edhe në aspektin e pamjes. Në Komentarin e Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, paragrafi 143, përmendet detyrimi i gjyqtarit për të shmangur ndikimin e papërshtatshëm, duke treguar kujdes të veçantë për t’u siguruar që sjellja apo gjykimi as në subkoshiencën e tij nuk është ndikuar nga marrëdhënie të familjarëve, miqve apo kolegëve të tij.

29.2. Për sa sipërrasyetuar, pavarësisht se nuk provohet *marrëdhënie shoqërore apo miqësore* e subjektit të rivlerësimit me avokatin A. Z., fakti që ai ka udhëtuar dy herë me të është konfirmuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, një herë në Strugë, Maqedoni, në shkurt të vitit 2010, kur ka shkuar për të dhënë leksion në Universitetin {***} të Strugës, periudhë kur z. A. Z. nuk ushtronte profesionin e avokatit³¹, një herë për të parë ndeshjen në mars të vitit 2011, në Mynih, Gjermani. Ky fakt vlerësuar së bashku me përdorimin e automjeteve në pronësi të shtetasve, të cilët mund njihen në komunitet si persona me influencë politike apo në pronësi të shoqërisë tregtare, si arsyetuar në paragrafin 26.7 të këtij vendimi, çon në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte qenë më i kujdesshëm në veprimet e tij për të shmangur perceptimin e publikut se gjyqtari është duke përfituar për shkak të detyrës. Po kështu, përdorimi i automjeteve me tri akte noteriale, që përcaktojnë afat 1-vjeçar ose afat të pacaktuar, si dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka qenë i kujdesshëm ndaj përmbajtjes së kontratave që i ka nënshkruar vetë ose dhe prokurës që i ka atribuar tagra përtej përdorimit, në vlerësim të trupit gjykues nuk i përgjigjet pritshmërisë për standardin e sjelljes së gjyqtarit.

- 30.** Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit në lidhje me ankimin dhe shqyrtoi provat e administruara, arrin në përfundimin se në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përdorimi i automjetit në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, vetëm për një rast, nuk mund të klasifikohet si trajtim preferencial i subjektit të rivlerësimit, po kështu përdorimi i automjeteve të personave të tjerë analizuar më sipër edhe marrëdhënia me avokatin A. Z., siç rezulton nga analizimi i fakteve dhe rrethanave të kësaj çështjeje, nuk janë të mjaftueshme sa të konsiderohen se kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë në atë nivel për të aplikuar nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
- 31.** Në kushtet kur për subjektin e rivlerësimit, Komisioni, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, nuk ka konstatuar kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo veprimtari korruptive të tij dhe për aftësitë profesionale ka vlerësuar se arrin një nivel minimal kualifikues, Kolegji, pasi çmoi se ka nivel të besueshëm edhe në vlerësimin e kriterit të pasurisë, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit plotëson së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
- 32.** Në përfundim, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është marrë në vlerësim jo të drejtë të fakteve e provave të administruara prej tij gjatë hetimit administrativ e në zbatim të gabuar të legjislacionit të zbatueshëm e, për pasojë, duhet të ndryshohet.

³¹ *Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar të personit fizik “A. Z.” i regjistruar më datë 27.10.2010, për veprimtari në fushën e avokatisë, përfaqësime ligjore, ndërmjetësim etj.*

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 277, datë 21.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e subjektit të rivlerësimit, z. Niko Rapi, në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 08.11.2022.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi